

MENDIM PAKICE

1. Unë Firdes Shuli, në cilësinë e relatores së trupit gjykues, që ka kryer procesin e rivlerësimit të subjektit Artur Cara, kam propozuar shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit për shkak se sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka kryer deklarime të pasakta e të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror. Duke qenë se me shumicë votash është vendosur konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit, po paraqes argumentet që sipas meje duhet ta çonin në shkarkimin e tij nga detyra, si vijojnë:

2. Paraprakisht bëj me dije se në këtë mendim pakice nuk do të referoj veprimet hetimore të kryera në kuadër të një hetimi të thellë e shterues administrativ, të cilat janë të pasqyruara gjerësisht në rezultatet e hetimit administrativ, të dakordësuara dhe të miratuara nga të tre anëtarët e trupit gjykues me vendimin nr. 2, datë 20.6.2023, duke u fokusuar në barrën e provës që i ka kaluar subjektit për çdo gjetje të Komisionit, qëndrimin e subjektit dhe vlerësimin tim si anëtare në pakicë.

Në lidhje me pasurinë apartament me sipërfaqe 120 m², në pallatin *, nr. ***, blloku ****, rruga ****, ***, Tiranë**

3. Nga barra e plotë që i ka kaluar subjektit të rivlerësimit në përfundim të hetimit administrativ për këtë pasuri, duket se:

- Subjekti dhe bashkëshortja nuk justifikojnë tërësisht me të ardhura të ligjshme blerjen e pasurisë në çmimin 38.000 USD dhe mobilimin pjesor të tij deri në fund të vitit 2003, për shkak të një balance negative prej 2.022.808 lekësh.

- Burimi i krijimit të pasurisë në DPFID-në e vitit 2009 si prokuror dhe atë *Vetting* me kursime të akumuluar ndër vite, bie në kundërshtim me raportimin e noteres pranë DPPPP-së, e cila ka deklaruar si burim *dhuratë nga vëllai i bashkëshortes S. L., i cili jeton prej vitesh në Greqi*. Deklarimi i subjektit se jemi përpara një lapsusi nga ana e noteres, duket se nuk është i vërtetë, pasi në raportim janë përmendur fakte reale si: emri i vëllait të bashkëshortes së subjektit, z. S. L., si dhe fakti që ky shtetas në këtë periudhë ka jetuar në Greqi sipas vetëdeklarimeve të subjektit. Për më tepër, në kushtet kur nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme për pagesën e çmimit prej 38.000 USD, krijohet dyshimi se për këtë shkak, subjekti ka deklaruar përpara noteres se si burim për këtë shumë kanë shërbyer të ardhura të kumatit, i cili nuk ka pasur mundësi kursimi sipas analizës financiare të kryer nga Komisioni.

- Në lidhje me burimet e krijimit të pasurisë, subjekti ka deklaruar kursime vetëm nga të ardhura të tij dhe të bashkëshortes, ndërkohë që nga hetimi administrativ ka të dhëna se si burim kanë shërbyer: (i) dhuratë prej 38.000 USD nga shtetasi S. L.; (ii) hua e marrë nga një i afërm për shlyerjen e një pjese të çmimit të shitjes për të cilën subjekti nuk ka kryer deklarime. Në këto rrethana, e sidomos në kushtet kur blerja e pasurisë nuk është justifikuar me të ardhura të ligjshme nga kursimet familjare, subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën PFD të vitit 2009 dhe në atë *Vetting* në lidhje me burimet e krijimit të pasurisë.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

4. Përkundër sa arsyeton shumica në vendim, në vlerësimin tim, subjekti nuk ka vërtetuar të kundërtën për asnjë nga pikat e barrës së provës, arsyetuar si vijon.

4.1. Sa i takon balancës negative, kjo balancë ka rezultuar pasi, për shkak se pasuria është përfutur përpara se subjekti të bëhej subjekt deklarues, nga ana e Komisionit janë marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit se si burim për krijimin e pasurisë kanë shërbyer kursimet nga pagat e tij dhe të bashkëshortes deri në vitin 2003, kur është blerë pasuria, e cila është blerë dhe porositur prej të dy bashkëshortëve përpara se të fillonin bashkëjetesën në vitin 2004 dhe bazuar në këtë deklaram është kryer analiza financiare për të dy duke konsideruar vetëm të ardhurat dhe shpenzimet jetike të tyre, pa përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet jetike apo investimet nga familjet respektive të origjinës ku kanë jetuar të dy bashkëshortët gjatë asaj periudhe. Në parashtrimet e tij subjekti kundërshton këtë analizë financiare, duke deklaruar se bashkëshortja ka kontribuar me të gjitha të ardhurat e saj në blerjen e pasurisë, duke pretenduar që në analizën financiare të mos llogariten shpenzime jetese të saj për shkak se këto shpenzime i janë mbuluar nga familja e saj. Shumica e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim me arsyetimin se bashkëshortja e subjektit nuk ka qenë në një certifikatë familjare me subjektin dhe nuk ka plotësuar deklaratime periodike si person i lidhur.

Unë si anëtare në pakicë nuk jam dakord me këtë arsyetim pasi, në vlerësimin tim, deklarimi i subjektit sipas të cilit bashkëshortja e tij ka kontribuar me të gjitha të ardhurat e saj pa i llogaritur shpenzime jetese i ngritur për herë të parë në parashtrime, bie në kundërshtim me deklaramin e mëparshëm të tij se si burim për krijimin e pasurisë kanë shërbyer kursimet nga pagat e tij dhe të bashkëshortes dhe është ngritur pikërisht kur subjekti ka konstatuar balancën negative të konstatuar nga Komisioni. Megjithatë, duke qëndruar në logjikën e shumicës, po vijoj me një analizë të këtij pretendimi.

Konkretisht, subjekti sqaron se bashkëshortja ka jetuar në familje me prindërit dhe motrën e saj, të cilët kanë qenë të punësuar (vëllai larguar në vitin 1995 në emigracion) dhe bazuar në të ardhurat e tyre ka paraqitur një analizë financiare sipas së cilës, familja e bashkëshortes ka pasur të ardhura të ligjshme financiare të mjaftueshme për t'i përballuar shpenzimet vajzës së tyre R. C. dhe për t'i mundësuar asaj kursimin e të ardhurave nga pagat e saj për periudhën 1995 – 2003, në shumën 3.031.152 lekë. Subjekti ka paraqitur gjithashtu një deklaratë në datën 10.7.2023, të lëshuar nga prindërit e bashkëshortes që banojnë në SHBA, të cilët deklarojnë se bashkëshortja e subjektit ka jetuar në familjen e tyre deri në kurorëzimin në martesë në vitin 2005 (sipas subjektit ai dhe bashkëshortja kanë filluar bashkëjetesën në vitin 2004) dhe se ata kanë mbuluar gjithë shpenzimet e saj duke mundësuar kursime të pagave të saj që prej vitit 1995 për blerjen e apartamentit. Në vijim, subjekti deklaron se nuk kanë mbajtur ditar kontabël për pagesat e kryera për blerjen e apartamentit, por deklaron se nga ana e bashkëshortes së tij është paguar shuma 3.031.152 lekë (pra më shumë se kontributi i tij), që është e ardhura në total e siguruar nga paga e saj për periudhën 1995 – 2003 dhe pjesa tjetër nga ana e tij. Ai ka paraqitur edhe një analizë financiare sa i përket mundësisë së kursimit nga ana e tij për periudhën 2000 – 2003, sipas së cilës, ai ka mundur të kursejë shumën 1.221.770 lekë. Sipas subjektit, ai me bashkëshorten kanë mundur të kursejnë në total shumën 4.252.922 lekë, që ka shërbyer për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 120 m². Diferenca nga totali i çmimit të blerjes prej 5.065.474 lekësh¹ prej 812.552 lekësh është mbuluar nga kursimet e tij nga punësimi në Itali.

¹ Ka një diferencë prej 584 lekësh në çmimin total të blerjes së apartamentit të konkluduar nga shumatorja e pagesave sipas kësteve të konvertuara në datat e pagesave sipas mandateve nga ana e Komisionit (5.066.058 lekë) dhe atij të konkluduar nga ana e subjektit (5.065.474 lekë). Diferenca mund të rrjedhë nga rrumbullakosja e vlerave pas konvertimeve përkatëse, e cila nuk mbart efekt të konsiderueshëm financiar në analizë.

Nga analiza e parashtrimeve të subjektit rezulton se në arsyetimin dhe analizën financiare të kryer nga subjekti për të vërtetuar mundësinë e kursimit të shumës prej 3.031.152 lekësh nga bashkëshortja e tij (pra, gjithë të ardhurat nga paga e saj në periudhën 1995 – 2003), vërehet se janë paraqitur dy variante, një variant duke përfshirë të ardhura të tre familjarëve të saj (pa përfshirë të ardhurat e bashkëshortes) dhe tjetri duke i përfshirë edhe të ardhurat e bashkëshortes së tij. Për sa i përket shpenzimeve jetike, ato janë konsideruar në të dyja variantet për katër pjesëtarë të familjes (duke përfshirë dhe bashkëshorten e tij). Në këto analiza financiare nuk janë përfshirë investime të mundshme të kryera nga familja L. gjatë kësaj periudhe. Gjatë procesit të hetimit, sipas shkresës kthim përgjigjeje nr. 4077 prot., datë 27.5.2021, të UKT-së, ka të dhëna që babai i bashkëshortes ka investuar vlerën 2.600.000 lekë për blerjen e apartamentit me sip. 78.2 m², në rrugën “****”², Tiranë, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.10.2002.

Nisur nga arsyetimi i subjektit dhe bazuar në dokumentacionin e të ardhurave të familjarëve të bashkëshortes së subjektit, vënë në dispozicion të Komisionit gjatë procesit të hetimit³, u krye analiza financiare ku rezultoi se familja L. nuk ka pasur mundësi për kursim për shkak të një balance negative prej 995.472 lekësh pa konsideruar të ardhurat e bashkëshortes së subjektit, dhe në vlerën prej 1.501.287 lekësh nëse në këtë analizë do të konsideroheshin të ardhurat e bashkëshortes, të cilat, sipas subjektit, janë përdorur të gjitha për blerjen e apartamentit të tyre me sip. 120 m². Nëse do të konsiderohej edhe kontributi prej 50.000 lekësh (pjesa takuese bashkëshortes për parapagim mobilimi në vitin 2003, që sipas subjektit vlere e mobilimit e paguar në vitin 2003 është 100.000 lekë), pretendim të cilin unë nuk e kam vlerësuar të arsyeshëm (trajtuar në pikën 4.2. në vijim), rezultati negativ do të dilte në vlerën prej 1.551.287 lekësh.

Pra, edhe nëse merret në konsideratë pretendimi i subjektit se bashkëshortja e tij ka kontribuar me të gjitha të ardhurat duke mos i llogaritur shpenzimet e jetesës të cilat presupozohet se i janë mbuluar nga familja për periudhën 1994 – 2003, balanca negative e analizës financiare të familjes së bashkëshortes me të dhënat që disponohen është 995.472 lekë. Në këto kushte, familja e saj nuk ka pasur mundësi për të përballuar shpenzimet e jetesës së znj. C., sikurse subjekti pretendon.

Sa i takon mundësisë së kursimit të shumës 1.221.770 lekë në periudhën 2000 – 2003 nga ana e subjektit, në analizën e tij financiare të paraqitur me parashtrimet subjekti nuk ka përfshirë kontributin e tij prej 2.034.906 lekësh⁴ për blerjen e apartamentit me sip. 120 m². Duke e përfshirë këtë vlerë, rezultati i analizës financiare do të dilte me vlerë negative prej 813.136 lekësh. Nëse do të shtonim edhe vlerën prej 50.000 lekësh⁵ si kontribut për parapagimin e mobilieve në vitin 2003, atëherë rezultati negativ do të ishte 863.136 lekë.

4.2. Sa i takon shpenzimeve të mobilimit të apartamentit objekt vlerësimi prej 120 m² të cilat janë pjesë përbërëse e analizës financiare, subjekti kundërshton shpërndarjen nga ana e

² Sipas dokumentacionit bankar të vënë në dispozicion të Komisionit gjatë procesit të hetimit, rezulton si adresë banimi e prindërve të bashkëshortes së subjektit, apartament në rrugën “****”, Tiranë. Meqenëse ky apartament duket të jetë blerë në vitin 2002, nuk ka informacion në lidhje me adresa të mëparshme, ku mund të ketë jetuar familja L.

³ Shihni dokumentacionin për të ardhurat e babait të bashkëshortes M. L.; nënës së bashkëshortes L. L. dhe motrës së saj A. L. të dërguar nëpërmjet *email*-it nga subjekti në datën 14.4.2023 në vijim të dokumentacionit shoqëruar të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

⁴ Kjo është shuma që rrjedh nga diferenca e totalit të shumës së paguar për blerjen e apartamentit prej 5.066.058 lekë (ekuivalent i 38.000 USD) me kontributin prej 3.031.125 lekësh e pretenduar në parashtrimet e subjektit si kontribut nga bashkëshortja e tij për blerjen e apartamentit me sip. 120 m².

⁵ Subjekti deklaron në parashtrimet e tij si shpenzim për mobilim për apartamentin me sip. 120 m² për vitin 2003 shumën prej 100.000 lekësh. Këtu konsiderohet kontributi i tij prej 50% të kësaj shume.

Komisionit të vlerës 1.500.000 lekë në periudhën 2003 – 2005, duke iu referuar përgjigjeve të pyetësorit standard dhe atij nr. 2, ku ka thënë se shpenzimet janë kryer në periudhën 2003 – 2005 dhe në vijim. Sipas subjektit, shpenzimet e kryera për mobilimin e apartamentit me sip. 120 m² në total vlerën 1.500.000 lekë, përfshirë këtu edhe pajisjet elektroshtëpiake, janë kryer në periudhën 2003 – 2010 dhe jo vetëm në vitet 2003 – 2005 sikurse është konsideruar nga Komisioni. Gjithashtu, subjekti vijon se kreditë të marra në Raiffeisen Bank në vitet 2008 – 2009 për blerje pajisjesh elektroshtëpiake, gabimisht janë përfshirë nga Komisioni si shpenzim shtesë përtej vlerës 1.500.000 lekë, pasi kjo vlerë përfshin si mobilimin ashtu edhe blerjen e pajisjeve elektroshtëpiake.

Siç vërehet në faqen 19 të vendimit kur është kryer analiza e likuiditetit *cash* prej 1.600.000 lekësh i deklaruar në DPFĐ-në e vitit 2009, nga ana e shumicës konsiderohen të bazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me periudhën e mobilimit dhe shpenzimet e mobilimit të cilat janë shpërndarë sipas pretendimeve të tij në periudhën 2003 – 2010.

Nuk jam dakord me përfundimin e shumicës se shuma prej 1.500.000 lekësh për mobilimin e banesës është shpenzuar gjatë periudhës 2003 – 2010, duke arsyetuar se subjekti shpjegoi bindshëm lidhur me rishpërndarjen e tyre në këto vite. Në vlerësimin tim, edhe pse në parashtrime ka deklarime më të detajuara në lidhje me vlerat dhe periudhat përkatëse të mobilimit, krahasuar me të dhëna të paraqitura gjatë hetimit administrativ, subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar pretendimet në lidhje me shtrirjen e shpenzimeve të mobilimit në periudhën 2003 – 2010. Sa i takon referimit të subjektit në deklarimet e tij sipas të cilave shpenzimet janë kryer në periudhën 2003 – 2005 e në vijim, vlerësoj se kjo duhet të jetë për shkak të faktit se, në vitet 2008 – 2009, pra në vijim, subjekti ka blerë pajisje elektroshtëpiake nëpërmjet kredive të cilat ishin përlogaritur mbi vlerën 1.500.000 lekë të konsideruar nga Komisioni.

Në këto kushte, vlerësoj se përlogaritja e shpenzimeve të mobilimit duhet të bëhet ashtu sikurse ishte bërë edhe në përfundim të hetimit administrativ gjatë periudhës 2003 – 2005 duke iu referuar deklarimeve të subjektit, sipas të cilit mobiliet dhe pajisjet kryesore, konkretisht dhomën e gjumit dhe kuzhinën e kanë porositur në fund të vitit 2003 për t'u prodhuar gjatë vitit 2004 për të mundësuar hyrjen në banesë me martesën e tij në maj 2005, duke i dhënë peshën më të madhe vitit 2004, vit në të cilin u llogaritën 50% të shpenzimeve, pasi subjekti deklaroi fillimin e bashkëjetesës me bashkëshorten. Ndërsa 20% u konsideruan shpenzim gjatë vitit 2003 dhe 30% në vitin 2005. Më tej, në vitet 2008 – 2009 subjekti ka kryer shpenzime ka investuar për blerjen e pajisjeve elektroshtëpiake nëpërmjet kredive.

Por, në vlerësimin tim, ashtu sikurse edhe për shumicën, konsiderohet i bazuar pretendimi që gabimisht si shpenzime mobilimi dhe pajisjesh elektroshtëpiake, përtej shumës prej 1.500.000 lekësh ishte konsideruar dhe vlera e blerjes së pajisjeve elektroshtëpiake prej 200.700 lekësh, të cilat ishin blerë me kredi në vitet 2008 – 2009. Në këto kushte, si shpenzime mobilimi për periudhën 2003 – 2005 duhet të merret shuma 1.299.300 lekë (1.500.000 lekë - 200.700 lekë që janë përfituar me kredi nga Raiffeisen Bank), duke u reflektuar kjo edhe në analizën financiare të periudhës përkatëse.

4.3. Sa i takon konstatimeve në lidhje me burimet e pasurisë referuar: (i) deklarimeve në raportimin e noteres në DPPP, sipas të cilave burimi i pasurisë është dhuratë nga vëllai i bashkëshortes, z. S. L., i cili jeton prej vitesh në Greqi; (ii) huas së marrë nga një i afërm për shlyerjen e një pjese të çmimit të shitjes, sipas të dhënave në dokumentet e bankës, për të cilat subjekti nuk ka kryer deklarime, shumica ka vlerësuar se nuk ka kushte për të krijuar dyshime

për fshehjen e burimit të pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe nuk u konstatua asnjë veprim apo përpjekje e subjektit për të deformuar apo manipuluar të vërtetën në funksion të paraqitjes së rreme të të dhënave lidhur me pasurinë e tij. Sipas shumicës, subjekti ka deklaruar në vijimësi se si burim krijimi për këtë pasuri kanë qenë kursime nga punësimi i tij dhe i bashkëshortes dhe në asnjë moment nuk ka deklaruar se burim krijimi i kësaj pasurie është një dhuratë apo hua nga person i paidentifikuar.

Më tej, shumica konsideron se pasaktësitë e rezultuara në dokumentacionin ligjor për përfitimin e pasurisë nuk gjejnë mbështetje në asnjë nga deklaratimet e bëra nga ana e tij në ILDKPKI, deklaratë para fillimit të detyrës, deklaratat e interesave private apo dhe deklaratën e pasurisë *Vetting*. Siç vërehet nga arsyetimi, shumica pranon se ka pasaktësi, por ato janë të tilla që nuk rezultuan të jenë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarimin e pasaktë të të dhënave lidhur me këtë pasuri të paluajtshme. Në përfundim, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, arsyetohet se rrethanat e konstatuara lidhur me dokumentacionin ligjor nuk përbëjnë arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe nuk kanë afektuar deklarimin e kësaj pasurie të paluajtshme në deklaratën *Vetting* të vitit 2017.

Përkundër sa arsyeton shumica, në vlerësimin tim subjekti nuk ka provuar të kundërtën e konstatimit se subjekti ka deklaruar si burim kursime vetëm nga të ardhura të tij dhe të bashkëshortes, ndërkohë që nga hetimi administrativ ka të dhëna se si burim kanë shërbyer: (i) dhuratë prej 38.000 USD nga shtetasi S. L.; (ii) hua e marrë nga një i afërm për shlyerjen e një pjese të çmimit të shitjes, për të cilat subjekti nuk ka kryer deklarime. Në këto rrethana, e sidomos në kushtet kur blerja e pasurisë justifikohet me të ardhura të ligjshme nga kursimet familjare, në vlerësimin tim subjekti ka kryer deklarime të pasakta e të pamjaftueshme në deklaratën PFD të vitit 2009 dhe në atë *Vetting* lidhje me pasurinë objekt vlerësimi dhe burimet e krijimit të pasurisë. Për të arritur në këtë përfundim, kam analizuar parashtrimet e subjektit në raport me faktet dhe rrethanat e rezultuara gjatë procesit të rivlerësimit, arsyetuar si vijon.

Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij paraqet të njëjtat shpjegime të dhëna në përgjigje të pyetësorit nr. 2, sipas të cilave raportimi i noterës është një lapsus, duke rikujtuar se *në të njëjtën datë e njëjta notere, ka bërë lapsusin me raportimin pasardhës lidhur me shtetasin P. Z.* Ky argument i subjektit nuk është i pranueshëm përderisa noteria në këtë rast ka dhënë prova e argumente bindëse në lidhje me vënien gabimisht të emrit të bashkëshortes si palë në aktin noterial, që në rastin konkret është vërtet një lapsus nga ana e noterës (trajtuar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ). Sipas subjektit, i vetmi shpjegim që ai prezumon në lidhje me raportimin e emrit të kunatit të tij nga noterja si dhurues i shumës 38.000 USD, është keqperceptimi (nga ana e noterës) i bisedave/diskutimeve që mund të jenë bërë mes tij dhe bashkëshortes në zyrën e noterës për dhurata të vogla martesore, tradicionale për eventin e martesës, gjatë hartimit të kontratës së shitblerjes së apartamentit me sip. 120 m². Por sipas subjektit, edhe kjo nuk qëndron, pasi nëse noterja do të kishte lexuar me kujdes kontratën e porosisë dhe mandatpagesat bashkëlidhur kontratës, do të konstatonte se të gjitha pagesat për likuidimin e vlerës totale të apartamentit janë kryer nga ai dhe/apo bashkëshortja e tij. Ky argument i subjektit nuk është i arsyeshëm, pasi në këto akte që ai referon pasqyrohet se nga kush janë kryer pagesat dhe jo burimi i tyre. Sipas subjektit, raportimi i noterës është i njëanshëm, i pakonfirmuar prej tij, i cili ka ardhur në dijeni për këtë fakt vetëm nëpërmjet pyetësorit të dërguar nga Komisioni.

Po kështu sipas subjektit, si raportimi i noteres ashtu edhe të dhënat bankare për një hua të marrë nga një i afërm i tij nuk gjejnë mbështetje në asnjë dokument shkresor të depozituar pranë Komisionit nga ana e tij apo siguruar nga ana e Komisionit, nuk gjen mbështetje në asnjë nga deklaratimet e bëra nga ana e tij në ILDKPKI, deklaratën para fillimit të detyrës, deklaratat e interesave privatë dhe deklaratën e pasurisë *Vetting*. Subjekti vijon të theksojë se si burim krijimi për këtë pasuri kanë qenë kursime nga punësimi i tij dhe i bashkëshortes për të cilat referuar analizës financiare të kryer prej tij u provua ligjshmëria e krijimit të tyre. Sipas tij, në asnjë moment nuk ka deklaruar se burim krijimi i kësaj pasurie është një dhuratë apo hua nga person i pidentifikuar. Nëse do të kishte qenë një nga këto variante, padyshim do ishte deklaruar prej tij së paku në vitin 2009, në deklaratë përpara fillimit të detyrës, kohë kur nuk mendohej se do t'i nënshtrohej një hetimi të mirëfilltë administrativ.

Siç vërehet, përgjithësisht subjekti përpiqet të argumentojë se pasaktësitë e bëra nga noterja në lidhje me një dhurim nga kunati S.L. apo punonjësi i bankës në lidhje me huan, nuk kanë pasur një qëllim të caktuar dhe se janë bërë në padijeninë e tij, pavarësisht nga ai, ose në pakujdesinë e tij për t'i verifikuar në kohën kur janë kryer.

Në analizë të parashtrimeve të subjektit, në vlerësimin tim argumentet e paraqitura nga ai janë jobindëse, pasi vijnë në kundërshtim me prova konkrete, të cilat tregojnë se për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi janë përdorur burime të ndryshme nga ato që subjekti ka deklaruar, kursime familjare, dhe se, subjekti nuk ka kryer deklarime në lidhje me këto dy burime, duke u vënë në kushtet e pasaktësisë dhe pamjafueshmërisë në deklarime.

Konkretisht, vlerësoj se, në kushtet kur në raportimin e noteres janë përmendur fakte reale si: emri dhe mbiemri i saktë i vëllait të bashkëshortes së subjektit, z. S. L. si dhe fakti që ky shtetas në këtë periudhë ka jetuar në Greqi sipas vetëdeklarimeve të subjektit, deklarimi i burimit të krijimit të pasurisë në raportimin e noteres pranë DPPP-së me përshkrimin “Dhuratë nga vëllai i gruas S. L., i cili jeton prej vitesh në Greqi”, nuk mund të jetë një lapsus apo një “gabim” i saj për shkak të keqperceptimit prej saj të bisedave të bëra në zyrën e noteres kur është përpiluar akti i shitjes. Për më tepër, në kushtet kur nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme të bashkëshortëve Cara për pagesën e çmimit 38.000 USD për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, mbetet dyshimi se pikërisht për këtë shkak, përpara noteres është deklaruar se si burim për këtë shumë kanë shërbyer të ardhura të kunatit të subjektit.

Sa i takon konstatimit në lidhje me një hua që është përdorur për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi për të cilën subjekti nuk ka kryer deklarime, në parashtrimet e tij, subjekti ka vijuar të japë sqarime si në *email* të dërguar Komisionit në datën 14.6.2023, sipas të cilave apartamenti me vlerë 38.000 USD ishte shlyer tërësisht deri në dhjetor të vitit 2003, fakt i cili rezulton tërësisht i provuar me mandatpagesat e depozituara në Komision. Ndër të tjera, subjekti shprehet se: “*Nuk ka kuptim të kem kërkuar informacion nga Banka Credins sh.a. për shlyerje detyrimesh për këtë apartament, ndërkohë që apartamenti ka qenë i regjistruar në ZVRPP në pronësinë time dhe personit të lidhur në atë kohë (viti 2003)*”. Këto argumente të subjektit nuk qëndrojnë, përderisa në dokumentet e bankës pasqyrohet qartësisht fakti se çmimi i shitjes së apartamentit ishte paguar, porse cilësohet se subjekti kishte marrë një hua për të paguar një pjesë të çmimit të blerjes së pasurisë dhe se kredia do të jepej pikërisht për këtë qëllim.

Subjekti vijon të sqarojë në lidhje me objektin e kredisë të financuar nga Credins Bank me kontratën e kredisë bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.5.2010, duke theksuar se qëllimi

i saj, ashtu si shpjeguar në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka qenë për sistemimin dhe arredimin e dhomës së fëmijëve në vitin 2010, dhe jo për shlyerje detyrimi.

Në mbështetje të argumenteve të tij, subjekti sqaron ka depozituar komunikimin elektronik me Credins Bank në datën 12.7.2023, i cili duket të jetë dërguar nga adresa elektronike e Credins Bank⁶ ku citohet se: *“Lidhur me informacionin e kërkuar nga ana juaj si e paraqitur edhe në dokumentet (kontratë kredie), qëllim i kredisë ka qenë “blerje/investim në blerje apartamenti”. Në këtë periudhë kreditë hipotekore për qëllim blerjeje apo investim në apartament klasifikoheshin në të njëjtën fashë të kredive afatgjata housing. Duke qenë se dosja juaj e kredisë është mbyllur dhe arkivuar në dokumentet në përbërje të dosjes suaj të kredisë nuk ka asnjë kontratë/deklaratë huaje mes palësh të treta ashtu sikurse edhe veprimi i tërheqjes cash, por edhe çdo dokument tjetër i plotësuar nga ju dhe dokumentuar në kontratë kredie na bën të mendojmë që specifikimi në raport analizë marrje huaje nga person i afërm mund të jetë mbartje ose lapsus i një punimi/analize të mëparshme që nuk ka të bëjë me rastin tuaj”.*

Në analizë të parashtrimeve të subjektit dhe dokumenteve të paraqitura prej tij vlerësoj se, pretendimet e tij në lidhje me objektin e kredisë dhe qëllimin e përdorimit të saj per kryerje investimesh për sistemim/mobilim banese në vitin 2010 mbeten të pambështetura për sa kohë:

i) Në formën e aplikimit firmosur nga subjekti qëllimi i kredisë cilësohet “këst apartamenti”.

ii) Objekti i kredisë në kontratën e kredisë cilësohet “investim blerje apartamenti”.

iii) Në dokumentin “plani i investimit” ku cilësohen të dhëna konkrete si, apartamenti me sip. 120 m², datë 18.7.2009 e lidhjes së kontratës së shitjes së këtij apartamenti me palë blerëse Artur Cara, është shkruar shprehimisht se z. Cara po merr kredi për shlyerjen e një huaje që ka marrë për të paguar çmimin e apartamentit.

iv) Në asnjë prej DPV-ve, në deklaratën Vetting dhe në përgjigje të pyetësorit standard nuk janë kryer deklarime për shpenzime/investime për arredim apo sistemim banese në vitin 2010 dhe as fakti që kredia e vitit 2010 është përdorur për arredim/sistemim banese. Vetëm gjatë pyetjes pranë ILDKPKI-së në vitin 2016 dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka deklaruar në lidhje me përdorimin e kredisë së vitit 2010 për shpenzime arredimi e sistemimi banese. Por, këto deklarime sipas të cilave qëllimi i kredisë ka qenë për arredimin/sistemimin e dhomës së fëmijëve në vitin 2010, bien ndesh me deklarin në DPV për vitin 2010, i cili është provë shkresore sipas parashikimit të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, ku subjekti ka deklaruar marrje kredie “për shlyerje detyrimi për apartamentin ku banon në ***”, deklarim i cili është në të njëjtën linjë me përshtkrimin në aktin bankar “plani i investimit”, ku cilësohet që z. Artur pohon se një pjesë e pagesës për blerjen e apartamentit në vitin 2009 janë likuiduar para nënshkrimit të kontratës me fondet e vetë klientit ndërsa pjesa tjetër është financuar me një hua nga një i afërm i tij. Për këtë arsye z. Artur po aplikon pranë bankës sonë për një kredi në shumën 15.000 euro me qëllim likuidimin e detyrimit ndaj të tretëve”.

v) Në deklaratën Vetting ku subjektit i është dhënë mundësia e një deklarimi të ri sipas udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, nëpërmjet të cilit mund të saktësonte/rregullonte deklarime të mëparshme të tij, ai nuk ka kryer asnjë deklarim në lidhje me investime për sistemimin/mobilimin e banesës nëpërmjet kredisë së marrë në vitin 2010.

⁶ Shihni komunikimin nëpërmjet email-it të datës 12.7.2023 nga adresa elektronike e L. Gj. ***@bankacredins.com në vëmendje të B. T. ***@bankacredins.com në dokumentacionin e parashtrimeve të subjektit në dosjen e Komisionit.

vi) Në komunikimin elektronik me Credins Bank në datën 12.7.2023, përcaktohet se qëllimi i kredisë ka qenë “blerje/investim në blerje apartamenti”. Në këtë komunikim vërehet se nga njëra anë bëhet me dije se nuk ka asnjë akt në dosje që i përket kësaj kredie, dhe nga ana tjetër deklarohet se mungesa e një kontrate/deklarate huaje na bën të mendojmë që specifikimi në “Raport Analizë” i marrjes së huas nga një person i afërm mund të jetë mbartje ose lapsus i një punimi/analize të mëparshme që nuk ka të bëjë me rastin tuaj. Veç kësaj, në këtë komunikim nuk ka një konkluzion përfundimtar për sa është kërkuar nga subjekti, pasi është përdorur shprehja *na bën të mendojmë*. Dhe në përfundim, në vlerësimin tim, specifikimi në aktin bankar i titulluar “Raport Analizë” i marrjes së huas nga një person i afërm i subjektit me të cilën është paguar një pjesë e çmimit të blerjes së pasurisë në Laprakë, dhe për shkak të shlyerjes së të cilës është aplikuar për të marrë kredi në vlerën 15.000 euro në vitin 2010, nuk mund të jetë mbartje ose lapsus i një punimi/analize të mëparshme që nuk ka të bëjë me rastin e subjektit (sikurse është shprehur në komunikimin elektronik me subjektin në datën 12.7.2023), pasi përshkrimi në aktin bankar përputhet plotësisht me të dhëna të subjektit, si gjeneralitete të tij, datën e kontratës së blerjes së pasurisë apartament në Laprakë dhe të dhëna të përshkruara në këtë kontratë.

Në këto kushte, të dhënat e përshkruara në aktet bankare në lidhje me kredinë e marrë në vitin 2010 prej 15.000 euro dhe qëllimin e saj duke i vlerësuar në raport me deklarin e subjektit në DPV-në për vitin 2010, ku qëllimi i kredisë është deklaruar *për shlyerje detyrimi për apartamentin ku banon në Laprakë*, jo vetëm që nuk mund të anashkalohen, por janë prova që hedhin dritë mbi detyrime financiare të padeklaruara që nga viti 2003 deri në vitin 2010, pikërisht për shkak të një huaje prej 15.000 eurosh që duket se është marrë përpara vitit 2003 kur sipas mandatpagesave ka përfunduar pagimi i çmimit të apartamentit. Megjithatë, për një qëndrim sa më garantist ndaj subjektit dhe për të mos rënduar pozitën e tij, dhe në kushtet kur nuk ka një provë të drejtpërdrejtë që vërteton një hua të marrë nga subjekti i rivlerësimit para vitit 2003, i qëndroj vlerësimit të Komisionit në përfundim të hetimit administrativ, sipas të cilit kredia prej 15.000 euro, përfituar në vitin 2010, është konsideruar e përdorur si burim për sistemim dhe arretim të pasurisë objekt verifikimi gjatë këtij viti. Nëse kjo kredi nuk do të ishte konsideruar si e tillë, por do të konsiderohej si burim për shlyerjen e një detyrimi të padekluar, viti 2010 do të bëhej negativ.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi, në vlerësimin tim, subjekti: (i) ka kryer deklarime të pasakta e të pamjaftueshme në kundërshtim me pikën 1 të nenit 32, shkronjën “a” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 19 të udhëzimit nr. ***, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së; (ii) nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme blerjen e pasurisë në kuptim të shkronjës “c” të nenit 33 të ligjit. Për rrjedhojë, ka deklarime të pamjaftueshme për këtë pasuri në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me pasurinë apartament me sipërfaqe 72.9 m², në Lagjen nr. *, Sarandë**

5. Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i kaloi barra e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, ku duket se:

- Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* vlerën e saktë të pasurisë, pasi ka deklaruar vetëm vlerën e karabinasë prej 16.000 euro dhe burimin e saj. Po kështu, ka pasaktësi në deklarin e burimit pasi është shtuar gjendje nga kredia e marrë në datën 17.5.2010, në shumën 15.000 euro.

- Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur mundësi për kursime në periudhën 1.1.2012 – 16.5.2012 për pagimin e shumës 10.000 euro në datën 23.2.2012 dhe shumës 6.000 euro në datën 16.5.2012, pasi rezulton me balancë negative në total prej 767.234 lekësh.

- Subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur mundësi financiare për përfundimin e punimeve për shkak të një balance negative prej 269.793 lekësh në vitin 2013 dhe 479.904 lekë në vitin 2014.

6. Pas vlerësimit të parashtrimeve të subjektit, unë, si anëtare në pakicë, vlerësoj se përkundër sa ka arsyetuar shumica, subjekti nuk ka arritur të vërtetojë të kundërtën e barrës së provës për asnjë nga konstatimet e Komisionit.

6.1. Konkretisht, në parashtrimet e paraqitura nga subjekti dhe analizën financiare të paraqitur prej tij, rezulton se:

- Për sa i përket mosdeklarimit në deklaratën *Vetting* të vlerës së saktë të pasurisë objekt verifikimi, subjekti i referohet shumës 16.000 euro në kontratën e shitjes së sendit në të ardhmen nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.2.2012, në të cilën parashikohet shprehimisht që palët kanë rënë dakord që pala blerëse ta blejë këtë apartament të papërfunduar, pa u bërë rifiniturat e brendshme në objekt, pa u shtruar apartamenti me pllaka, pa u vendosur dritaret e dyert, pa u vendosur pajisjet hidrosanitare, punime të cilat do të kryhen totalisht nga pala blerëse me shpenzimet e veta. Por pavarësisht këtij pershkrimi, subjekti pretendon se nuk bëhet fjalë për objekt në gjendje karabinaje, por për objekt të përfunduar, për të cilin palët kanë rënë në marrëveshje që të përzgjidhen në raport me shijet personale pllakat, hidrosanitaret, materialet e dritareve dhe të dyerve të brendshme.

- Për sa i përket pasaktësisë në deklarimin e burimit në deklaratën *Vetting*, ku si burim është deklaruar gjendje nga kredia e marrë në datën 17.5.2010, në shumën 15.000 euro, subjekti vijon të deklarojë sikurse edhe gjatë procesit se është një lapsus duke kërkuar sërish që Komisioni ta konsiderojë lapsus këtë deklaram të tij.

- Për sa i përket mundësisë për kursime për blerjen e apartamentit, në parashtrimet e tij, subjekti kundërshton rezultatin e analizës financiare të kryer nga Komisioni duke paraqitur analizën financiare të kryer nga ana e tij për periudhën 1.1.2005 – 9.12.2009, për krijimin e gjendjes *cash* prej 1.600.000 lekësh të deklaruar në DPFD-në e vitit 2009. Sipas tij, ai dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për ta kursyer këtë shumë për shkak të rezultatit pozitiv të analizës financiare dhe, si e tillë, kjo shumë duhet të konsiderohet në analizën financiare nga ana e Komisionit si burim për blerjen e apartamentit me sip. 79.2 m² në Sarandë, blerë në vitin 2012. Në analizën e tij subjekti nuk ka përfshirë: (i) ndryshime likuiditetesh të bashkëshortes së tij pavarësisht se ajo ka pasur një llogari bankare pranë BKT-së në emër të saj, të çelur në vitin 2004. Si rrjedhojë, ndryshimi i likuiditeteve në vitet 2005 dhe 2006 nuk është pasqyruar në zërin pasuri të analizës; (ii) nuk ka përfshirë shpenzime për mobilim në vitin 2005 për apartamentin në ***. Këto përllogaritje të subjektit nuk bazohen në dokumente shkresore.

- Për sa i përket përllogaritjes së kryer nga ana e Komisionit të vlerës së punimeve për përfundimin e objektit, subjekti kundërshton vlerat e përfshira në analizën financiare të kryer nga Komisioni duke vënë në dukje se *nëse diskutohet që në momentin e blerjes objekti ka qenë karabina, referimi duhet të jetë në kosto ndërtimi dhe vlera e apartamentit do të dalë mbi bazën e koston së ndërtimit, ose nëse do të konsiderohet i përfunduar, do të vlerësohet me vlerë*

mesatare të shitblerjes së apartamenteve në tregun e lirë. Por, pavarësisht kësaj, nuk rezultojnë të ketë bërë vetë ndonjë përlllogaritje sipas këtij sugjerimi, por vijon të pretendojë si shpenzime për përfundimin e punimeve të apartamentit vlerën 320.000 lekë, por tashmë të ndarë në periudhën 2012 – 2014, sikurse dhe Komisioni kishte vepruar, duke e pasqyruar këtë fakt në analizën financiare të paraqitur me parashtrimet.

6.2. Nga analizimi i parashtrimeve të subjektit, unë vlerësoj se:

- Sa i takon mosdeklarimit të vlerës së saktë të pasurisë në deklaratën *Vetting*, subjekti është i paqartë dhe kontradiktor në parashtrimet e veta. Megjithatë, asnjë nga pretendimet dhe argumentet e paraqitura nuk mund të justifikojë mosdeklarimin e vlerës së plotë të pasurisë sipas parashikimit të shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, në momentin e deklarimit, datë 25.1.2017, kur është plotësuar deklarata *Vetting*, që përbëhet nga 16.000 euro, paguar për blerjen në vitin 2012 plus minimalisht investimi i pretenduar nga vetë subjekti prej 320.000 lekësh për të përfunduar punimet në periudhën 2013 – 2016. Për më tepër, në deklaratën *Vetting* ashtu sikurse edhe në DPV-të e viteve 2012 – 2016, pra pas vitit 2012 kur u ble apartamenti i papërfunduar, subjekti mungon të ketë kryer deklarime në lidhje me investimet për përfundimin e punimeve, vlerën e tyre dhe burimin e të ardhurave (deklarime të kryera gjatë vetëm procesit të rivlerësimit), duke vështirësuar kështu punën e Komisionit për të përlllogaritur vlerën e saktë të shpenzimeve për përfundimin e punimeve shtesë dhe periudhat përkatëse.

- Për sa i përket deklarimit në deklaratën *Vetting* të gjendjes nga kredia e marrë në datën 17.5.2010, në shumën 15.000 euro si burim për krijimin e pasurisë së blerë në vitin 2010, në vlerësimin tim, nisur nga kuptimi i fjalës “lapsus” nuk çmoj që subjekti të ketë bërë një lapsus në deklarim, porse, subjekti në rastin më të mirë është treguar i pakujdesshëm në plotësimin e deklaratës *Vetting*.

- Sa i përket pretendimit që apartamenti nuk është blerë në gjendje karabinaje, ky pretendim nuk qëndron, ashtu sikurse ka arsyetuar dhe pranuar dhe shumica.

- Në parashtrime subjekti pranon se punimet shtesë janë kryer në periudhën 2012 – 2014, sikurse Komisioni kishte vlerësuar në rezultatet e hetimit, deklarim i cili bie në kundërshtim me deklarimet e mëparshme të tij në përgjigje të pyetësorit standard dhe gjatë hetimit administrativ sipas të cilave punimet janë kryer në periudhën 2013 – 2016. Duke qenë se në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se me një kredi të vitit 2016 kishte shlyer detyrimet për kryerjen e punimeve shtesë gjatë viteve 2013 – 2016, me njoftimin e rezultateve të hetimit i kaloi barra e provës për të dhënë sqarime në lidhje me mosdeklarimin e detyrimeve financiare në asnjë prej DPV-ve të këtyre viteve. Subjekti në parashtrime nuk ka dhënë asnjë sqarim në lidhje me këtë konstatim, ndërkohë që sikurse është trajtuar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ, kredia e marrë në vitin 2016 nuk mund të ketë shërbyer si burim për shlyerje detyrimesh financiare (të padeklaruara) për përfundimin e punimeve, pasi nuk ka dokumentim të shlyerjes së ndonjë detyrimi financiar, nuk ka deklarim detyrimesh financiare në DPV-të e viteve 2013 – 2016 e për më tepër, nuk ka deklarim të likuidimit të këtyre shpenzimeve as në DPV-në e vitit 2017 (meqenëse nga kredia janë tërhequr 4.745 euro në janar 2017). Në këto kushte, deklarimi i burimit të kryerjes së punimeve shtesë në deklaratën *Vetting* është i pasaktë.

- Sa i takon vlerës së investimeve për përfundimin e punimeve, subjekti është i paqartë në parashtrimet e tij, të cilat mbeten në kuadër deklarativ dhe pavarësisht se ka dhënë sugjerime për mënyrën e përlllogaritjeve të shpenzimeve për punimet shtesë, ka vijuar të konsiderojë si

vlerë punimesh vlerën 320.000 lekë të deklaruar vetëm gjatë procesit të rivlerësimit, pa paraqitur asnjë dokument për të vërtetuar këtë vlerë. Po kështu në parashtrime mungojnë të jenë dhënë sqarime a deklarime në lidhje me shlyerje detyrimesh ndaj personit fizik “****”, sikurse subjekti kishte deklaruar gjatë hetimit administrativ, i cili, siç ka rezultuar nga hetimi, nuk ishte regjistruar si person fizik sikurse subjekti ka deklaruar. Në këto kushte, i qëndroj mënyrës së përllogaritjeve të kryera nga Komisioni në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me investimet për punimet shtesë.

Në përfundim, unë vlerësoj se subjekti nuk ka kundërshtuar me prova dhe argumente bindëse barrën e provës për këtë pasuri. Përkundrazi, mosdeklarimi i investimeve për punimet shtesë dhe vlerës së tyre në asnjë prej DPV-ve dhe as në deklaratën *Vetting*, ndryshimi i qëndrimit në parashtrime në lidhje me periudhën e kryerjes së punimeve për përfundimin e apartamentit vetëm pasi është njohur me konstatimet e Komisionit, si dhe mosparaqitja e parashtrimeve në lidhje me kredinë e marrë në vitin 2016 që në deklaratën *Vetting* ishte deklaruar si burim për shlyerjen e detyrimeve financiare për shkak të kryerjes së punimeve shtesë, detyrime të padeklaruara në asnjë prej DPV-ve të viteve 2013 – 2016, krijojnë bindjen që deklarimet e subjektit në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi janë të pasakta e të pamjaftueshme për një vlerësim objektiv në kuadër të procesit të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016, dhe në vlerësimin tërësor të çështjes çmohen si shkaqe në favor të masës disiplinuese të shkarkimit nga detyra.

6.3. Sa i takon pretendimeve në lidhje me shpenzimet e udhëtimit, vlerësoj se duhet të pranohen pjesërisht. Konkretisht, në analizën finale financiare sipas vlerësimit tim: (i) për udhëtimin në vitin 2008 në Kanada, nuk duhen konsideruar shpenzimet e biletave pasi vlerësoj të janë mbuluar nga motra e bashkëshortes së subjektit, referuar provave shkresore që subjekti paraqiti; (ii) për udhëtimin në vitin 2007 në Maqedoninë e Veriut, të hiqet shpenzimi për kartonin jeshil duke u konsideruar që është paguar nga pronari i mjetit; (iii) duhet të reduktohen shpenzimet e transportit si i punësuar jashtë Tiranës për vitin 2005, pasi nga muaji tetor 2005 subjekti ka qenë i komanduar në Tiranë. Po kështu është pranuar pjesërisht edhe pretendimi për ndryshimin e vlerës së shpenzimeve të mobilimit të apartamentit me sip. 120 m² (trajtuar më sipër), e cila për vitin 2005 ndryshon nga 450.000 lekë në 389.790 lekë. Këto ndryshime afektojnë rezultatin e analizës financiare për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në DPFD-në e vitit 2009 nga subjekti, i cili ka qenë një prej burimeve për blerjen e apartamentit objekt verifikimi në Sarandë. Si rrjedhojë, gjendja *cash* e përdorur për blerjen e apartamentit rritet nga vlera 1.289.278 lekë në 1.583.408 lekë.

Në përfundim të procesit, në vlerësimin tim, balanca negative për blerjen e pasurisë objekt verifikimi në çmimin 16.000 euro në vitin 2012 ndryshon nga -767.234 lekë në -473.104 lekë. Ndërsa balanca negative për kryerjen e punimeve shtesë nuk ndryshon nga ai që është paraqitur në rezultatet e hetimit administrativ.

6.4. Bazuar në të gjitha sa më sipër, në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi, subjekti: (i) ka kryer deklarime të pasakta e të pamjaftueshme si në DPV, e ashtu dhe në deklaratën *Vetting* në kundërshtim me pikën 1 të nenit 32 dhe shkronjën “a” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 19 të udhëzimit nr. ***, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së; (ii) nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme investimin e pasurinë në kuptim të shkronjës “c” të nenit 33 të ligjit, si dhe ka kryer deklarime kontradiktore në lidhje me periudhën e punimeve shtesë dhe burimin e krijimit të të ardhurave në këtë investim. Për rrjedhojë, ka deklarime të pamjaftueshme për këtë pasuri në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Konstatime të tjera të evidentuara gjatë hetimit administrativ, nga të cilat kam veçuar vetëm ato për të cilat janë evidentuar problematika.

Sa i takon transaksioneve dhe veprimeve juridike e financiare të kryera nga bashkëshortja e subjektit, znj. R. C.

7. Gjatë hetimit administrativ kanë rezultuar një numër i konsiderueshëm veprimesh juridike e financiare të kryera nga ana e bashkëshortes së subjektit në emër dhe për llogari të të afërmeve të saj, shtetasve M. P. dhe Ll. Z. (përkatësisht halla dhe bashkëshorti i vajzës së hallës së bashkëshortes së subjektit), si dhe znj. Xh. Z., bashkëshorte e z. Ll. Z. Sa i takon statusit juridik të këtyre shtetasve, në përfundim të hetimit administrativ, këta persona u konsideruan persona të tjerë të lidhur, sipas parashikimit të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Kjo në konsideratë të fakteve dhe provave të rezultuara në aktet në dosjen e ILDKPKI-së, por dhe nga hetimi administrativ, si vijojnë.

- Me prokurën e posaçme datë 21.2.2000, me vërtetim të noteres K. P. nr. *** kol., nr. *** rep., datë 21.2.2000, shtetasit M. P. dhe Ll. Z. emërojnë si përfaqësuesen e tyre bashkëshorten e subjektit, znj. R. L., me të cilën kanë lidhje farefisnore, që për llogarinë e tyre të kryejë blerjen e një dyqani me sip. 100 m² pranë shoqërisë “****” në bllokun “****” deri në mbylljen e kontratës përfundimtare. Sipas prokurës, znj. R. C. i është dhënë e drejta edhe e kryerjes së pagesave të kësteve për blerjen e pasurisë.

- Me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.10.2001, shtetasit Ll. Z., Xh. Z. dhe M. P. kanë blerë dyqanin nr. *** te objekti nr. ***, nga shoqëria “****” sh.p.k., në çmimin 4.280.000 lekë, likuiduar totalisht, e cila është nënshkruar personalisht nga të dyja palët.

- Me kontratë sipërmarrjeje datë 2.3.2005 e lidhur mes sipërmarrësit “****” dhe porositësve Ll. Z. dhe Xh. Z., këta kanë porositur një apartament me sip. 107 m², kontratë e nënshkruar nga vetë palët. Nga të dhënat bankare dhe deklaratimet e subjektit rezulton që znj. R. C. ka kryer transaksione bankare për pagimin e çmimit të shitjes.

- Me kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.12.2006, qiramarrëse R. C. (L.), e cila disponon prokurën nr. ***, datë 21.2.2000, i jep me qira shoqërisë “****” sh.p.k. (pa pasur të drejtë sipas prokurës) një dyqan të ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., me vlerë 600 euro/muaj, për një periudhë 5-vjeçare. Nga të dhënat bankare rezulton se një shumë e konsiderueshme e qirave kanë kaluar në llogari të bashkëshortes së subjektit në periudhën 2007 – 2011 (nga vitet 2009 – 2011 subjekti ka qenë në detyrë).

- Me deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.2.2016, administruar nga ILDKPKI-ja, por paraqitur edhe nga subjekti në përgjigje të pyetësorit standard, shtetasit M. P. dhe Ll. Z. deklarojnë se: “... në vitin 2000 kanë porositur për ndërtim pranë shoqërisë “****” një dyqan, i cili aktualisht është i regjistruar në emër të shtetasve Ll. Z., Xh. Z. dhe M. P. Për të kryer procedurat e nevojshme deri në lidhjen e kontratës përfundimtare të shitblerjes, nëpërmjet një prokure të posaçme (nr. ***, datë 21.2.2000), kanë emëruar përfaqësuesen e tyre R. L. (C.), meqë ata jetonin në Greqi dhe aq më tepër që Rajmonda është mbesa e M. P. Përveç dyqanit, tek po e njëjta shoqëri, është porositur edhe një apartament me sip. 107 m² dhe R. ka qenë përfaqësuese e tyre në këtë shoqëri. Gjithashtu, Rajmonda i ka përfaqësuar edhe në marrëdhëniet me shoqërinë “****” sh.p.k., të cilës i kishin dhënë me qira dyqanin e sipërcituar. Për këto arsye, R. i dërgoheshin vazhdimisht vlera monetare, me bankë ose cash”.

- Nga të dhënat bankare vërtetohet se bashkëshortja e subjektit ka pasur një llogari të përbashkët me shtetasin Ll. Z. pranë Bankës Kombëtare të Greqisë (NBG), llogari e hapur në datën 10.12.2001 dhe mbyllur në datën 29.1.2014 pranë Bankës Kombëtare të Greqisë (blerë nga ABI Bank në vitin 2018). Janë evidentuar kreditime në këtë llogari në vlerën 85.002 euro dhe debitime (tërheqje *cash*/transferime) në vlerën 84.512 euro deri në datën 26.6.2009.

- Nga të dhënat bankare vërtetohen transaksione bankare si derdhje e tërheqje shumësh të konsiderueshme *cash* prej bashkëshortes së subjektit, i cili pretendon se i takojnë anëtarëve të familjes Zyberli.

Ndodhur përpara provave dhe rrethanave të sipërpërmendura, gjatë hetimit Komisioni ka ngritur dyshime të arsyeshme për pasuri (të luajtshme dhe të paluajtshme) të fshehura në emër të subjektit dhe/ose bashkëshortes së tij, duke kryer hetime në lidhje me: (i) një njësi dhe një apartament banimi të blera nga shtetasit M. P., Ll. Z. Xh. Z.; (ii) një llogari bankare të përbashkët të bashkëshortes së subjektit me shtetasin Ll. Z.; (iii) disa kreditime në llogari të bashkëshortes së subjektit nga shtetasja Xh. Z.; (iv) kryerjen e transaksioneve financiare të bashkëshortes së subjektit për blerjen e pasurive të tyre; (v) administrimin prej saj të të ardhurave nga qiraja e dyqanit në pronësi të shtetasve Ll. Z., M. P. dhe Xh. Z., duke i konsideruar ata persona të tjerë të lidhur sipas parashikimit të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 (trajtuar në paragrafët në vijim).

Në parashtrimet e tij subjekti e ka kundërshtuar këtë konstatim të Komisionit, duke dhënë sqarime të detajuara dhe ngritur pretendime për mungesën e lidhjeve të tij dhe bashkëshortes me dy pasuritë apartament dhe njësi të familjes Z., si dhe kryerjen e transaksioneve bankare dhe veprimeve juridike nga bashkëshortja e tij në emër dhe/për llogari të familjes Z., vetëm për shkak të lidhjeve të ngushta familjare dhe pa asnjë përfitim/interes nga ana e tij dhe e bashkëshortes së tij (trajtuar në vijim rast pas rasti).

Duke iu referuar vendimeve nr. 8 (JR), datë 25.6.2020; nr. 4 (JR), datë 9.2.2021; nr. 33 (JR), datë 3.11.2021, të Kolegjit, subjekti pretendon se nga hetimi administrativ *nuk rezulton asnjë e dhënë apo dyshim i ngritur në nivel të arsyeshëm gjatë hetimit që pasuritë e regjistruara në emër të familjarëve të bashkëshortes të jenë pasuri e fshehur nga unë subjekti i rivlerësimit apo familja ime. Në këto rrethana, vlerësoj se familjarët e bashkëshortes, shtetasit Ll. Z., Xh. Z. dhe M. P. nuk mund të kualifikohen si persona të tjerë të lidhur, në përputhje me parashikimet ligjore të neneve 30-32 të ligjit nr. 84/2016 që rregullojnë këtë status e, për pasojë, detyrimi për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të familjarëve të bashkëshortes, vlerësoj se është një detyrim në tejkalim të parashikimeve ligjore”.*

Në analizë të parashtrimeve të subjektit dhe përkundër sa pretendon ai, gjatë hetimit administrativ, rezultuan të dhëna, fakte dhe prova të mjaftueshme për ngritjen e dyshimit të arsyeshëm për pasuri të fshehura nga subjekti, për të cilat Komisioni u detyrua të kryejë hetime, dhe në vlerësimin tim, disa prej dyshimeve nuk janë rrëzuar edhe në përfundim të procesit, arsyetuar hollësisht rast pas rasti në këtë mendim pakice. Po kështu, ka pasur mjaftueshëm të dhëna të cilat kanë ngritur dyshime të arsyeshme mbi mungesën e një interesi nga ana e bashkëshortes, sikurse subjekti pretendon, për kryerjen e kaq shumë veprimeve në favor të të afërmeve të saj.

Në përfundim, në vlerësimin tim, referuar jurisprudencës së Kolegjit, i cili e lidh kualifikimin e personave të tjerë të lidhur me dyshime për pasuri të fshehura në emër të tyre, për shembull vendimit nr. 33 (JR), datë 3.11.2021, të Kolegjit, i cili është shprehur se: “...në këto rrethana,

duke konstatuar gjithashtu se nuk rezultojnë nga aktet e administruara gjatë hetimit të dhëna apo dyshime që kjo pasuri, e cila ka qenë e regjistruar në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit, është një pasuri e fshehur e tij, situatë e cila do të legjitimonte Komisionin të bënte hetime në këtë drejtim, trupi gjykues arrin në përfundimin se nëna e subjektit të rivlerësimit nuk mund të kualifikohet si person tjetër i lidhur, në përputhje me parashikimet ligjore që rregullojnë këtë status e, për pasojë, detyrimi që Komisioni i ka ngarkuar subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e gjendjeve të llogarive bankare në emër të saj në vitin 2016, është një detyrim në tejkalim të parashikimeve ligjore...”, pretendimet e subjektit se anëtarët e familjes Zyberli nuk janë persona të tjerë të lidhur, është i pabazuar.

8. Në lidhje me transaksionin bankar pranë BKT-së, në vlerën 11.975 euro, me përshkrimin “Tërheqje nga llogaria R. C. në datën 25.11.2009”

Pasi janë kryer verifikimet në lidhje me depozitimin e shumës 11.985 euro në datën 23.11.2009 në numrin e llogarisë së shtetases R. C. pranë BKT-së prej shtetases A. M., tërhequr nga bashkëshortja e subjektit në vlerën 11.975 euro, në datën 25.11.2009, në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i kaloi barra e provës, ku duket se mbetet i pavërtetuar burimi i shumës 11.975 euro dhe është e paqartë përse kjo shumë nuk ka kaluar direkt në llogarinë bankare të shtetases D. A., po ka kaluar në emër të bashkëshortes së subjektit. Në këto kushte, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën financiare deri në datën 23.11.2009, kur këto fonde janë kredituar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit, për të verifikuar mundësinë e kursimit nga ana e saj, nga e cila dukej një balancë negative prej 363.422 lekësh. Në ushtrim të barrës së provës, subjekti ka paraqitur parashtrime dhe dokumente shkresore dhe në përfundim të procesit shumica i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, duke arritur në përfundimin se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, konkluzion me të cilin bie dakord edhe unë.

9. Në lidhje me transaksionin bankar të datës 22.4.2010 pranë BKT-së, për tërheqje nga llogaria bankare në emër të znj. R. C., të vlerës 11.500 euro

Pasi janë kryer verifikimet është konstatuar në datën 21.12.2009 ka një depozitim në *cash* nga shtetasja R. C. në llogarinë e saj pranë BKT-së (nr. ***) në shumën 9.900 euro, të cilat sipas deklaratës noteriale të datës 18.2.2016 i janë dhënë asaj nga shtetasit M. P. dhe Ll. Z. dhe në datën datë 22.4.2010 znj. C. ka tërhequr shumën 11.500 euro, ku përfshihet edhe shuma 9.900 euro. Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i kaloi barra e provës, duket se është e paqartë: (i) përse shuma 9.900 euro i është dhënë *cash* nga ana e Ll. Z. dhe/ose M. P. R. C., e cila i depozitoi në *cash* në llogarinë e saj personale pranë BKT-së, në datën 21.12.2009, për t'ia kthyer prapë në *cash* disa muaj më vonë, në datën 25.4.2010, ndërkohë që sipas sistemit TIMS shtetasja M. P. ka qenë në Shqipëri gjatë gjithë kësaj periudhe dhe mund ta administronte vetë këtë shumë; (ii) pse kjo shumë nuk ka kaluar në rrugë bankare në llogarinë e përbashkët të z. Ll. Z. me bashkëshorten e subjektit. Në këto kushte, në përfundim të hetimit administrativ, në analizën financiare të vitit 2009, shuma prej 9.900 euro, depozituar në datën 21.12.2009 nga shtetasja R. C., është konsideruar si pasuri e saj. Ky vit rezulton me balancë negative (shihni analizën financiare përfundimtare). Në lidhje me këto konstatime, subjektit i ka kaluar barra e provës.

Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, shumica e ka vlerësuar të bazuar pretendimin e subjektit, i cili kërkon nga Komisioni mospërfshirjen e shumës prej 9.900 euro në analizën financiare, pasi kjo shumë nuk i përket familjes së tij, pasi nuk ka asnjë marrëdhënie interesi, tagër për ta përfituar apo për ta përdorur këtë shumë, duke arsyetuar se: “Në analizë të

arsyetimit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, duke mbajtur në konsideratë se nga bashkëshortja e subjektit është deklaruar që në deklarimin e interesave privatë para fillimit të detyrës 2009, marrëdhënia me këta familjarë të saj ka deklaruar të ardhura në llogari në BKT, në shumën 600 euro/muaj, si person i autorizuar me prokurë për tërheqjen e tyre nga pronari Ll. Z., duke vlerësuar se kjo marrëdhënie datonte sipas dokumentacionit ligjor të administruar gjatë hetimit administrativ prej vitit 2000 para fillimit të punës nga subjekti dhe para martesës së tyre, Komisioni i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me arsyet dhe qëllimin e kryerjes së këtyre transaksioneve nga bashkëshortja e tij, duke arritur në përfundimin se nuk kemi të bëjmë me pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016”.

Unë si anëtare në pakicë nuk jam dakord me këtë vlerësim të shumicës, pasi për efekt të procesit të rivlerësimit të kriterit pasuror gjatë ushtrimit të detyrës, në kuadër të ligjit nr. 84/2016, duhet t’i nënshtrohen një verifikimi të plotë të gjitha transaksionet bankare të kryera nga subjektet dhe bashkëshortët e tyre edhe përpara se ata të fillonin ushtrimin e detyrës, ashtu sikurse ka ndodhur edhe në rastin e subjektit Cara, me qëllim krijimin e një tabloje sa më të qartë e të plotë të veprimeve me efekt juridiko-financiar, të cilat mund të ndikojnë periudhën kur subjektet kanë qenë në detyrë. Për më tepër, subjekti përpara se të fillonte detyrën e prokurorit ka qenë OPGJ, pra pjesë e sistemit të drejtësisë, por më kryesorja është se prokura e posaçme e vitit 2000 nuk i ka dhënë të drejtë bashkëshortes së subjektit për të kryer transaksione financiare, të cilat, siç kanë rezultuar gjatë hetimit, ka pasur raste që i përkasin edhe periudhës kur subjekti ka qenë në detyrë.

Në një vlerësim të të gjitha provave, unë si anëtare në pakicë vlerësoj se subjekti nuk ka vërtetuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit në lidhje me transaksionin bankar të datës 22.4.2010. Konkretisht, në parashtrimet e tij subjekti vijon të japë sqarime në lidhje me marrëdhënien e veçantë dhe gatishmërinë e bashkëshortes për t’i ndihmuar familjarët e saj, duke iu referuar edhe deklaratave noteriale të tyre depozituar pranë Komisionit. Ai thekson se shuma 9.900 euro është kërkuar nga familja Z. të depozitohet *cash* në llogarinë e bashkëshortes në BKT, ku kanalizoheshin edhe qiratë e dyqanit në pronësi të familjes Z., me qëllim që kjo shumë të tërhiqej së bashku me qiratë e akumuluar për t’u investuar në mobilimin e apartamentit ku ata jetojnë. Sipas tij, nuk ka dijeni përse depozitimi i shumës 9.900 euro nuk u depozitua në llogarinë e shtetasit Ll. Z., por është depozituar në llogari të bashkëshortes së tij, por thekson se për bashkëshorten nuk kishte asnjë lloj rëndësie se në cilën llogari do të derdheshin likuiditetet, për shkak se ajo thjesht ofronte ndihmesën e saj dhe ka ekzekutuar transaksione bankare në përputhje me kërkesat e palës së interesuar.

Për sa i takon arsyet përse kjo shumë nuk është depozituar në llogarinë që shtetasi Ll. Z. ka pasur pranë NBG-së me bashkëshorten e tij, subjekti sqaron se nuk ka dijeni të saktë për arsyen pse, por ai thekson se për bashkëshorten e tij nuk kishte asnjë lloj rëndësie se në cilën llogari do të derdheshin likuiditetet, për shkak se ajo thjesht ofronte ndihmesën e saj dhe ka ekzekutuar transaksione bankare në përputhje me kërkesat e palës së interesuar.

Subjekti kërkon nga Komisioni mospërfshirjen e shumës prej 9.900 euro në analizën financiare, pasi ajo shumë nuk i përket familjes së tij, e cila nuk ka asnjë marrëdhënie interesi apo tagër për ta përfutuar apo për ta përdorur këtë shumë. Në mbështetje të parashtrimeve të tij, subjekti ka paraqitur:

- deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.6.2023, notere I. T., të shtetasës M. P.;

- deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.2.2016, e shtetasve Ll. Z. dhe M. P.;
- deklaratë përgjegjësie (sipas nenit 8 N.1599/1986), datë 28.6.2023, e shtetasit Ll. Z.⁷;
- kopje preventiv me shkrim dore me porositëse të mobilieve M. P., lëshuar nga subjekti D. U. (NIPT ***), me adresë N., Fushë Krujë, në datën 12.2.2010, në shumën 720.000 lekë.

Në përfundim, në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve të subjektit, si dhe gjithë provave e rrethanave të rezultuara nga hetimi administrativ, unë si anëtare në pakicë vlerësoj se nuk vërtetohet që shuma 9.900 euro i është dhënë bashkëshortes së subjektit nga Ll. apo M. Z., pasi mbetet e palogjikshme dhe e paqartë përse shuma 9.900 euro i është dhënë *cash* znj. R. C., e cila i depozitoi në *cash* në llogarinë e saj personale pranë BKT-së, në datën 21.12.2009, për t'ia kthyer prapë në *cash* znj. M. P. disa muaj më vonë në datën 25.4.2010, ndërkohë që sipas sistemit TIMS kjo shtetase ka qenë në Shqipëri gjatë gjithë kësaj periudhe dhe mund ta administronte vetë këtë shumë për ta përdorur për mobilimin e apartamentit, si dhe mbetet e paqartë pse kjo shumë nuk ka kaluar në rrugë bankare në llogarinë e përbashkët të shtetasit Ll. Z. me bashkëshorten e subjektit, në të cilën znj. C. kishte të drejtë veprimi, duke e tërhequr atë në çdo kohë. Për më tepër, me të dhënat që subjekti ka vënë në dispozicion nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme të familjes Z. deri në vitin 2009, kur është kryer derdhja në *cash* nga znj. R. C. në llogarinë e saj pranë BKT-së. Në këto kushte, në analizën financiare të vitit 2009, shuma prej 9.900 euro, depozituar në datën 21.12.2009 nga znj. R. C., datë në të cilën subjekti ka qenë në detyrë, duhet konsideruar, sikurse ishte konsideruar edhe në përfundim të hetimit administrativ.

10. Në lidhje me një llogari bankare pranë BKT-së në monedhën euro, në emër të bashkëshortes së subjektit⁸

Sipas ekstraktit të llogarisë bankare është kryer depozita *cash* nga znj. R. C. në vlerën 10.500,00 euro, në datën 23.5.2005, të cilat janë transferuar në depozitë me afat në emër të saj në datën 24.5.2005. Në datën 23.6.2005 nga kjo depozitë është tërhequr *cash* shuma prej 10.000 euro dhe shuma prej 500 euro është vendosur në depozitë të re. Në datën 16.12.2005, shuma 10.700 euro është depozituar në llogari dhe së bashku me principalin dhe interesin e depozitës me afat prej 500 euro, në total vlera 11.204,18 euro, është vendosur në depozitë me afat 6-mujor në datën 27.12.2005. Me maturimin e saj në datën 29.6.2006, shuma 11.318,18 euro është tërhequr *cash* nga bashkëshortja e subjektit. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti sqaron se shuma prej 11.318,18 euro i përket familjarëve të bashkëshortes që jetonin në ***, Greqi, me qëllim blerjen e pasurive të paluajtshme në Shqipëri.

Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve, ku duket se: në analizë të veprimeve bankare dhe deklarimeve të subjektit, mbetet i paqartë burimi i shumës 10.500,00 euro, depozituar nga bashkëshortja e subjektit fillimisht në datën 23.5.2005 dhe destinacioni i përdorimit të tyre pas tërheqjes *cash* të vlerës 11.318,18 euro në datën 29.6.2006. Në këto kushte, është kryer analiza financiare për të verifikuar mundësinë e kursimit nga ana e subjektit dhe bashkëshortes së tij në datat kur janë depozituar shumat, përkatësisht shuma 10.500 euro datë 23.5.2005 dhe 10.700 euro datë

⁷ Deklarata e përgjegjësisë e depozituar në dosjen e Komisionit është lëshuar nga institucion grek dhe mban kodin ***, ku teksti deklarues është në gjuhën shqipe në dokumentin origjinal të lëshuar në Greqi, sipas edhe konfirmimit të përkthyeses së autorizuar nga Ministria e Drejtësisë, znj. A. D. Dokumentacioni shoqërohet edhe me vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë 29.6.2023, të notere M. F. Xh.

⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.6.2021, të BKT-së, në dosjen e Komisionit.

27.12.2005, ku duket se bashkëshortja e subjektit dhe subjekti nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme.

Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se në datën 23.5.2005 shuma prej 36.370 euro është tërhequr nga shtetasi turk H. K. T. V., përfaqësues i shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. (nga e cila shtetasi Ll. Z. ka blerë një apartament banimi, trajtuar në vijim), vërtetuar me mandatpagesën datë 23.5.2005, lëshuar nga NBG Albania sh.a. Nga kjo shumë, pjesën prej 25.400 euro ky shtetas e ka arkëtuar në arkën e shoqërisë sipas mandatarkëtimit të së njëjtës datë 23.5.2005 dhe diferenca prej 10.970 euro i është dhënë shtetasit Ll. Z., e cila i është dhënë *cash* bashkëshortes së subjektit, e cila e ka depozituar në llogarinë e saj në datën 23.5.2005. Me këtë arsyetim, sipas subjektit, provohet edhe dhënia nga shtetasit Ll. dhe Xh. Z. e shumës 10.500 euro, e cila është depozituar në llogarinë e çelur nga znj. R. C. Për të vërtetuar pretendimet e tij, ka sjellë deklaratë të shtetasit Ll. Z.

Bazuar në deklaratimet e subjektit në parashtrime, shumica ka arsyetuar se *nga gjithë sa shpjeguar e analizuar më sipër, subjekti arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues se shuma 10.500 euro nuk është përfituar nga bashkëshortja dhe nuk është vënë në funksion të financave të tij dhe, për këtë arsye, kjo shumë nuk duhet të përfshihet në likuiditetet e tij në analizën financiare të kryer nga Komisioni.*

Nuk jam dakord me këtë konkluzion të shumicës, pasi pavarësisht se data në të cilën shtetasi turk H. K. T. V. ka tërhequr një shumë monetare (23.5.2005) dhe data e mandatarkëtimit në favor të shoqërisë (23.5.2005) përputhen me datën 23.5.2005 që bashkëshortja e subjektit ka depozituar shumën 10.500,00 euro, mbetet i pavërtetuar dhe në nivel deklarativ fakti që kjo shumë i është dhënë *cash* bashkëshortes së subjektit nga z. Z. Po kështu, mbetet e paqartë përse z. Z. ia ka dhënë këtë shumë *cash* bashkëshortes së subjektit, ndërkohë që ai ishte mbajtës i dy llogarive bankare në NBG, njëra prej tyre me bashkëshorten e subjektit. Më tej, mbetet i pavërtetuar destinacioni i shumës 11.318,18 euro, tërhequr nga bashkëshortja e subjektit në datën 29.6.2006.

Për rrjedhojë, referuar në sa më sipër dhe në kushtet kur nga veprimet bankare rezulton se bashkëshortja e subjektit është sjellë si pronare e shumës 10.500,00 euro dhe jo thjesht një poseduese e përkohshme e saj, në vlerësimin tim, shuma 10.500 euro duhet konsideruar ashtu sikurse ishte konsideruar në analizën financiare në përfundim të hetimit administrativ.

11. Në lidhje me dyqanin me sipërfaqe 100 m², blerë nga Ll. Z. etj.

11.1. Gjatë hetimit administrativ janë kryer verifikime të pasqyruara në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, në lidhje me një njësi të blerë me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.10.2001 nga shtetasit Ll. Z., Xh. Z. dhe M. P., të afërm të bashkëshortes së subjektit, në çmimin 4.280.000 lekë. Nga hetimi ka rezultuar se me kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.12.2006, nga bashkëshortja e subjektit R. C., në cilësinë e palës qiradhënëse, kjo pasuri i jepet me qira shoqërisë “****” sh.p.k., dyqani me sip. 107 m², me vlerë 600 euro/muaj, për një periudhë 5-vjeçare.

Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me këtë pasuri, për të cilën shumica nuk është shprehur në vendimin e saj, duket se bashkëshortja e subjektit është sjellë si pronare e pasurisë, pasi:

i) Ka lidhur një kontratë qiraje për njësinë objekt verifikimi dhe ka administruar të ardhurat nga qiratë, pa i pasur këto të drejta.

ii) Sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.11.2014, konfirmuar edhe nga FSHU-ja, znj. C. ka lidhur në emër të saj kontratën e energjisë elektrike (në vitin 2014 ka kërkuar ndryshimin e emrit të abonentit dhe lidhjen e kontratës në emër të z. Ll. Z.) për pasurinë njësi, ndërkohë që në vitin 2001, kur është lidhur kontrata e energjisë, pronarët janë pajisur me vërtetim pronësie dhe kontrata e energjisë elektrike duhet të ishte lidhur në emër të tyre.

iii) Kalimi i qirave nga shoqëria “****” sh.p.k. për dyqanin në pronësi të z. Ll. Z. etj. është bërë në llogari individuale të bashkëshortes së subjektit pranë BKT-së dhe jo në llogarinë bankare të përbashkët të këtij shtetasi me bashkëshorten e subjektit pranë NBG, e cila ishte hapur në datën 10.12.2001 dhe ka qenë aktive. Po kështu, shtetasi Ll. Z. ka pasur një llogari individuale pranë NBG, llogari kredie, dhe të ardhurat nga qiraja mund të shërbenin për pagesat automatike të kësteve të kredisë së disbursuar më 20.5.2005 pranë kësaj banke.

iv) Mbetet i paidentifikuar destinacioni i shumave të qirave të cilat bashkëshortja i ka tërhequr *cash*.

Bazuar në sa më sipër, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kërkuar të vërtetojë që përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, pasuria objekt verifikimi nuk është një pasuri e fshehur e tij dhe/ose e bashkëshortes së tij.

11.2. Në parashtrimet e tij, subjekti deklaron se:

- Sa i takon lidhjes së kontratës së qirasë dhe administrimit të të ardhurave nga qiraja pa pasur tagër, sqaron se nga pala qiramarrëse i është kërkuar bashkëshortes ndërmjetësim për këtë shërbim për marrjen e qirave, duke u shprehur se nga shumat e qirasë vlera prej 11.310 euro është depozituar në llogarinë e kredisë së shtetasit Ll. Z. pranë NBG-së (sikurse ka rezultuar edhe nga hetimi), ndërsa pjesa tjetër e qirave i është vënë në dispozicion familjes Z. Sipas subjektit, nga ana e familjes Z. nuk është ngritur asnjë pretendim për përvetësimin e këtyre të ardhurave nga ana e subjektit apo familjes së tij.

- Sipas subjektit, Kontrata e qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.12.2006 është lidhur para noterit publik, i cili ka konstatuar të rregullt aktin e përfaqësimit lëshuar në vitin 2000, cituar shprehimisht në përmbajtje të kontratës. Përfaqësimi i tyre nga ana e bashkëshortes, që i ka filluar në vitin 2000, është bërë me akt ligjor noterial dhe për rrjedhojë, çdo lëvizje bankare e bërë prej saj në kuadër të kësaj marrëdhënieje përfaqësimi ligjor, nuk mund të aludohet të jetë ndryshe. Sipas subjektit, neni 64 i Kodit Civil jep përkufizimin e përfaqësimit si vijon: “*Me përfaqësimin një person (përfaqësuesi) kryen, brenda tagrave që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuar)*”.

- Në lidhje me konstatimin e Komisionit që bashkëshortja e tij ka lidhur në emër të saj kontratën e energjisë elektrike, duke kërkuar në vitin 2014 ndryshimin e emrit të abonentit dhe lidhjen e kontratës në emër të shtetasit Ll. Z., ndërkohë që, në vitin 2001, kur është lidhur kontrata e energjisë, pronarët janë pajisur me vërtetim pronësie dhe kontrata e energjisë elektrike duhet të ishte lidhur në emër të tyre, subjekti sqaron se praktika e shoqërisë ndërtuese ishte çelja e kontratave dhe librezave të energjisë elektrike dhe ujësjellësit sipas listave emërore që shoqëria sipërmarrëse dispononte në bazë të kontratave të sipërmarrjes. Duke qenë se, kontratën e sipërmarrjes e ka nënshkruar bashkëshortja si përfaqësuese me prokurë të posaçme, sipas tij, i është kërkuar lëshimi i një deklaratë për çeljen e librezës në emër të pronarëve faktikë të pasurisë së paluajtshme.

- Në lidhje me konstatimin e Komisionit për kanalizimin e qirave të njësisë dyqan nëpërmjet BKT-së, ndërkohë që shtetasi Ll. Z. ka pasur dy llogari pranë NBG (sot ABI Bank sh.a.) në monedhën euro, njëra prej të cilave ishte llogari e lidhur me kredinë e marrë nga ky shtetas, subjekti sqaron se kanalizimi i qirave është bërë në sistemin bankar pranë një banke në të cilën operonte shoqëria ku bashkëshortja e tij ishte e punësuar. Gjithashtu, subjekti sqaron se kanalizimi i qirave nëpërmjet bankës NBG sh.a. nuk është kërkuar nga vetë shtetasi Ll. Z. dhe thekson se përfitues të qirave ishin edhe dy shtetase të tjera (M. P. dhe Xh. P. – Z.). Sipas subjektit, të afërmit e bashkëshortes kanë rregulluar marrëdhëniet financiare brenda kuadrit familjar.

- Për sa i përket destinacionit të përdorimit të shumave të tërhequra *cash* nga bashkëshortja e subjektit, subjekti deklaron se të afërmit e bashkëshortes kanë qenë investitorë të shumave të transferuara nëpërmjet llogarisë ndërmjetëse, si dhe përfitues të të ardhurave nga qiraja. Deri aktualisht, nuk ka asnjë pretendim nga të afërmit e bashkëshortes, por sqarime të të kundërtës sa pretenduar nga Komisioni, nëpërmjet deklaratave noteriale dhe ligjore depozituar pranë Komisionit⁹.

11.3. Në vlerësim të parashtrimeve të paraqitura nga subjekti, në vlerësimin tim:

- Nuk qëndrojnë pretendimet lidhur me përfaqësimin sipas ligjit me prokurën e vitit 2000, pasi kjo prokurë nuk i jep të drejtë bashkëshortes të japë me qira apo të administrojë të ardhurat nga qiraja. Referuar përmbajtjes së prokurës, është i pabazuar deklarimi i subjektit se *përfaqësimi i tyre nga ana e bashkëshortes, i ka fillesat në vitin 2000 dhe është bërë me akt ligjor noterial dhe, për rrjedhojë, çdo lëvizje bankare e bërë prej saj në kuadër të kësaj marrëdhënieje përfaqësimi ligjor, nuk mund të aludohet të jetë ndryshe*. Nga ana tjetër, vetë neni 64 i Kodit Civil, që subjekti referon, parashikon se i përfaqësuesi kryen, brenda tagrave që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuar).

- Referuar praktikës së shoqërisë ndërtuese, sipas vetëdeklarimit të subjektit në parashtrime *“Praktika e shoqërisë ndërtuese ishte çelja e kontratave dhe librezave të energjisë elektrike dhe ujësjellësit sipas listave emërore që shoqëria sipërmarrëse dispononte në bazë të kontratave të sipërmarrjes”*, nuk justifikohet lidhja e kontratës së energjisë elektrike në emër të bashkëshortes së subjektit dhe jo në emër të pronarëve/porositësve të pasurisë sipas kontratës së sipërmarrjes sipas listës emërore që ka disponuar shoqëria. Po kështu, vlen të theksohet se në vitin 2001 kur ishte lidhur kontrata e energjisë elektrike familja Z. e kishte fituar titullin e pronësisë me akt noterial të datës 25.10.2001, të nënshkruar nga blerësit Z. dhe pasuria ishte regjistruar në emër të tyre sipas vërtetimit hipotekor datë 14.11.2001.

- Nuk justifikohet kalimi i të ardhurave nga qiraja në llogari të bashkëshortes së subjektit, ndërkohë që një nga bashkëpronarët, Ll. Z., ka pasur llogari bankare në emër të vet, dhe për më tepër, qiratë mund të kreditoheshin direkt në llogarinë bankare pranë NBG-së, për pagimin e kësteve të kredisë së marrë prej tij në muajin maj 2005.

- Nuk vërtetohet destinacioni i një pjese të konsiderueshme i të ardhurave nga qiratë, të tërhequra *cash* nga bashkëshortja e subjektit, i cili është një rast i përsëritur prej saj.

⁹ Shihni deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.6.2023, të shtetases M. P.; deklaratë përgjegjësie datë 28.6.2023, të shtetasis Ll. Z.; deklaratë përgjegjësie datë 3.7.2023, të shtetases Xh. Z., në dokumentacionin shoqëruar të prapësimeve të subjektit, në dosjen e Komisionit.

- Së fundmi, është e vërtetë që pasuria njësi është përfituar në vitin 2000 nga Ll. Z. etj., vit në të cilin subjekti nuk ka qenë në detyrë, por vjelja dhe administrimi i qirave nga ana e bashkëshortes së tij, përkon me disa vite që subjekti ka qenë në detyrë, konkretisht në vitet 2009 – 2011. Për më tepër, mbetet e pajustificuar dhe e pakuptimtë e gjithë veprimtaria e bashkëshortes së subjektit, e cila në mënyrë të përsëritur ka kryer veprime financiare edhe pa qenë e autorizuar, në ndihme të familjes Z.

Në këto kushte, në vlerësimin tim, subjekti nuk ka kundërshtuar barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, si dhe faktin që nuk është në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, sa i takon pasurisë njësi objekt vlerësimi.

12. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 107 m², porositur nga Ll. Z. etj.

12.1. Nga të dhënat bankare rezultoi se në llogarinë dyemërore të bashkëshortes së subjektit me shtetasin Ll. Z. pranë NBG-së, janë kryer veprime bankare të përmbledhura në tabelën më poshtë:

Llog. NBG – Ll. Z. dhe R. C. (***)	Kreditime – Transferime në llogari nga Xh. P., bashkëshortja e shtetasit Ll. Z. (17.1.2002 – 18.8.2004)	31,938
	Debitime – <i>Tërheqje cash nga llogaria R. C. (4.2.2002 – 6.9.2004)</i>	24,425
	Debitime – <i>Tërheqje cash nga llogaria pa përshkrim emër personi</i>	7,543.5

Siç vërehet, në këtë llogari është transferuar nga shtetasja Xh. Z., bashkëshortja e z. Ll. Z., shuma në total prej 31.938 euro në periudhën 17.1.2002 – 18.8.2004, e cila është tërhequr *cash* dhe nga e cila shuma 24.425 euro vërtetohet të jetë tërhequr nga bashkëshortja e subjektit. Me kërkesë të Komisionit në lidhje me qëllimin e kreditimeve nga shtetasja Xh. Z. dhe destinacionin e përdorimit të shumave të tërhequra *cash* nga bashkëshortja e tij, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti deklaroi se bashkëshortja e tij ka kryer veprime financiare për blerjen e apartamentit me sip. 107 m² nga familja Z., me vlerë 53.590 euro, porositur me kontratë sipërmarrjeje datë 2.3.2005, me shuma monetare të dërguara nga shtetasit M. P. dhe Ll. Z. (subjekti i referohet këtyre shtetasve, por në fakt kreditimet janë bërë nga shtetasja Xh. Z., bashkëshorte e z. Ll. Z.).

12.2. Gjatë hetimit administrativ janë kryer verifikime të pasqyruara në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ në lidhje me një apartament banimi me sip. 107 m², i cili nuk rezultoi të jetë trajtuar në vendimin e shumicës, nga ku ka rezultuar se:

- Ky apartament është porositur me kontratë sipërmarrjeje datë 2.3.2005, të lidhur mes shoqërisë sipërmarrëse “***” sh.p.k. dhe porositësve Ll. Z. dhe Xh. Z., në çmimin 53.590 euro, nënshkruar nga palët pjesëmarrëse.

- Bashkëshortja e subjektit nuk ka qenë e autorizuar me ndonjë akt shkresor për përfaqësimin e blerësve në procedura të porositjes/blerjes së pasurisë apo kryerjen e veprimeve financiare në emër e për llogari të tyre.

- Çmimi për blerjen e apartamentit është vërtetuar të jetë paguar nga shtetasi Ll. Z. sipas mandateve që vetë subjekti ka paraqitur gjatë hetimit dhe trajtuar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ.

- Tërheqja e fondeve *cash* në shumën 24.425 euro nga znj. C. është kryer në vitet 2002 – 2004, pra përpara likuidimit të çmimit të shitjes sipas kontratës së sipërmarrjes datë 2.3.2005 dhe si të tilla, këto fonde nuk mund të jenë përdorur për blerjen e apartamentit.

- Referuar të dhënave të depozituara nga subjekti, duket se shtetasit Z. nuk kanë pasur mundësi për kursime për krijimin e shumes 31.938 euro me të ardhura të ligjshme dhe për rrjedhojë, as për blerjen e dy pasurive apartament banimi (dhe njësi të trajtuar më lart).

12.3. Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur ka qenë i pavërtetuar burimi i të ardhurave të shumës 24.425 euro dhe i pavërtetuar destinacioni i përdorimit të saj sipas deklarimeve të subjektit në dobi të blerjes së pasurisë apartament, sipas kontratës së sipërmarrjes datë 2.3.2005 nga Ll. Z. etj., nga Komisioni është verifikuar mundësia e krijimit me të ardhura të ligjshme të bashkëshortes së subjektit të fondeve të kredituara nga Xh. Z. në llogarinë e përbashkët të saj me shtetasin Ll. Z., si vijon: (i) në datën 7.11.2002, vlera 10.079 euro; (ii) në datën 10.6.2003, vlera 5.489 euro; (iii) në datën 30.7.2003, vlera 6.986 euro; (iv) në datën 18.8.2004, vlera 1.950 euro, nga ku duket se bashkëshortja e subjektit dhe subjekti nuk kanë pasur mundësi për të kursyer dhe mbuluar shpenzimet e tjera për shkak të balancave negative të pasqyruara në tabelën më poshtë:

Përshkrimi	1995 – 7.11.2002	1.1.2003 – 10.6.2003	10.6.2003 – 30.7.2003	30.7.2003 – 3.9.2003	1.1.2004 – 18.8.2004
Pasuritë	3,944,138	2,308,028	1,258,942	455,871	242,756
Apartament 120 m ² , blloku “****”, nr. pas. ***, vol. ***, z. k. ***	2,559,687	1,540,172	309,894		
Gjendja e likuiditeteve	1,384,451	767,856	949,048	1,404,920	242,756
Të ardhurat	3,802,488	470,868	74,394	174,797	501,465
Paga e subjektit	1,247,300	255,329	42,555	85,110	356,739
Paga e bashkëshortes	2,555,187	215,539	31,839	89,688	144,726
Shpenzimet	1,233,953	115,964	19,661	35,321	547,946
Shpenzime jetike subjekti	302,070	46,982	7,830	15,661	70,473
Shpenzime jetike bashkëshortja	807,884	46,982	7,830	15,661	70,473
Shpenzime udhëtimi (punësuar jashtë adresës së deklaruar të banimit)	124,000	22,000	4,000	4,000	32,000
Shpenzime mobilimi ap. 120 m ²	-				375,000
Mundësia për kursime	- 1 375 604	- 1,953,124	- 1,204,209	- 316,395	- 289 237

*Në këtë tabelë është përfshirë edhe analiza për kreditimin e shumës prej 10.479 euro nga M. M. në datën 3.9.2003 (trajtuar më poshtë).

Në këtë analizë, pavarësisht se bashkëshortja me subjektin nuk kanë qenë të martuar, janë konsideruar të ardhurat dhe shpenzimet për të dy, referuar faktit që është vërtetuar se ata kanë qenë në një lidhje që në vitin 2002 kur kanë kryer pagesa për blerjen e një apartamenti në ***.

Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

12.4. Në parashtrimet e tij, subjekti deklaron se shumata e transferuara në llogarinë e përbashkët të bashkëshortes së tij me shtetasin Ll. Z. nga shtetasja Xh. Z. janë përdorur kryesisht për likuidimin e njësisë/dyqan porositur pranë shoqërisë sipërmarrëse “***” sh.p.k. nga shtetasi D. S. në vitin 2003, bashkëshorti i hallës së bashkëshortes së tij R. C., bashkëshorti i tezes së Xh. P. Subjekti ka dhënë detaje për blerjen e një pasurie nga D. S. dhe ka paraqitur disa dokumente shkresore, ndër të tjera deklaratën e përgjegjësisë së shtetasës Xh. Z. me datë 3.7.2023, e cila deklaron se në periudhën 2002 – 2003 kushërinjtë Y. S. dhe M. S., të cilët janë djemtë e tezes së saj, znj. F. S., bashkëshorte e D. S., kanë porositur një lokal në Tiranë dhe një pjesë e parave për blerjen e pasurisë i janë dhënë asaj. Në vijim këto shuma janë dërguar prej saj në Shqipëri nëpërmjet transfertave bankare në llogarinë në NBG që kishte çelur bashkëshorti i saj (Ll. Z.) në Tiranë, kryesisht gjatë viteve 2002, 2003 e 2004, nga ku janë tërhequr më pas (nënkuptohet nga R. C., pasi emri nuk është përmendur) dhe përdorur për blerjen e lokalit të shtetasit D. S.

Subjekti vijon të theksojë se bashkëshortja dhe ai nuk kanë pasur asnjë përfitim material nga kjo marrëdhënie dhe se veprimet financiare të kryera prej saj kanë qenë ndihmesë e ofruar kundrejt kërkesës së familjarëve të shkallës së parë, shtetasve Z. dhe P. Subjekti kërkon nga Komisioni që shumata e transferuara në datat 7.11.2002, 10.6.2003, 30.7.2003 dhe 18.8.2004 të mos përfshihen në analizën financiare të kryer të tyre, meqenëse nuk janë përdorur nga bashkëshortja dhe nuk kanë qenë në funksion të financave të tij.

12.5. Siç vërehet, pasi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ dhe konstatimin se shuma prej 24.425 euro e tërhequr *cash* prej bashkëshortes së tij nuk është përdorur për blerjen e pasurisë apartament nga Ll. Z. etj., sikurse subjekti kishte deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka ndryshuar deklaratimet duke u shprehur se shumata e tërhequra nga bashkëshortja kanë shërbyer për blerjen e një pasurie tjetër të llojit lokal nga shtetasi D. S. Nga ana tjetër, ka të dhëna që tregojnë se shtetasi D. S. ka bërë dy pagesa në vitin 2003 në vlerën 40.000 USD, por mbetet e pavërtetuar që këto shuma janë paguar nga bashkëshortja e subjektit me shumata e tërhequra *cash* prej saj në periudhën 4.2.2002 – 6.9.2004. Për më tepër, mbetet i paqartë dhe i pajustificuar interesimi i bashkëshortes së subjektit dhe shkaku i këtij interesimi, për të kryer veprime financiare edhe në favor të shtetasës D. S. (përveç veprimeve në favor të familjes Z.).

Në këto kushte, vlerësoj se subjekti nuk ka kundërshtuar barrën e provës në lidhje me konstatimet e Komisionit dhe mbetet i pavërtetuar burimi dhe destinacioni i shumës 24.425 euro, depozituar nga shtetasja Xh. Z. dhe tërhequr nga bashkëshortja e subjektit në periudhën 4.2.2002 – 6.9.2004, e për rrjedhojë, kjo shumë duhet të konsiderohet ashtu sikurse ishte konsideruar në mbylljen e hetimit administrativ.

13. Në lidhje me transferimin e shumës 10.479 euro nga shtetasja M. M.

13.1. Gjatë hetimit administrativ janë kryer verifikime të pasqyruara në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ në lidhje me shumën prej 10.479 euro, transferuar në llogarinë e përbashkët të bashkëshortes me shtetasin Ll. Z. në datën 3.9.2003 nga shtetasja M. Marku, të cilat janë tërhequr më pas *cash* nga znj. R. C.. Konkretisht, në datën 10.9.2003 është tërhequr shuma 10.000 euro dhe pjesa tjetër është tërhequr disa muaj më vonë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti shpjegoi se shtetasja M. M. është bashkëshortja e shtetasit Y. S., djali i hallës së bashkëshortes, të cilët në vitin 2003 kanë porositur dhe blerë një njësi tek shoqëria “***” sh.p.k. Veprimet financiare dhe kontraktuale janë kryer nga babai i tyre D. S., ndërsa fondi i transferuar në datën 3.9.2003 nga shtetasja M. M. ka shërbyer për likuidim detyrimi për

njësine. Subjekti paraqiti¹⁰ deklaratë noteriale datë 24.5.2023 të shtetasës M. M., e cila deklaron se në vitin 2003 ka jetuar në ***, Greqi dhe vjehri i saj D. S. ka jetuar në Tiranë, i cili porositi një njësi në emër të tij dhe një pjesë të lekëve prej 10.479 euro, dërguar prej tyre nga Greqia në llogarinë e znj. R. L. C., pasi vjehri nuk kishte llogari të hapur në euro. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur dy mandatpagesa që shtetasi D. S. ka kryer për blerjen e një dyqani, si dhe dokumente që vërtetojnë të ardhura të familjes në Greqi. Por nuk ka dokumente që vërtetojnë blerjen e ndonjë pasurie prej tij.

13.2 Në kushtet kur nuk u vërtetua destinacioni i shumës 10.479 euro, ndërkohë që pohimet në deklaratën noteriale të datës 24.5.2023 janë në kuadër deklarativ, është kryer analiza financiare për mundësinë e kursimit nga ana e bashkëshortes së subjektit deri në datën 3.9.2003, kur është kredituar kjo shumë. Nga analiza e pasqyruar në tabelën 12.3 kur janë trajtuar kreditimet në llogarinë e bashkëshortes, të cilat janë tërhequr *cash* në vitet 2002 – 2004, duket se bashkëshortja e subjektit dhe subjekti kanë një balancë negative prej 316.395 lekësh.

Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

13.3. Në parashtrimet e tij, subjekti deklaron se shumata e transferuara në llogarinë e përbashkët të bashkëshortes me shtetasin Ll. Z. (subjekti nuk specifikon emrin e M. M.) janë përdorur kryesisht për likuidimin e njësisë/dyqan porositur pranë shoqërisë sipërmarrëse “****” sh.p.k. nga shtetasi D. S., në vitin 2003, si dhe ka paraqitur disa dokumente shkresore nga shqyrtimi i të cilave nuk vërtetohet blerja e njësisë në vitin 2003 nga shtetasi D. S. dhe as fakti që shumata e tërhequra *cash* nga bashkëshortja e tij janë përdorur për blerjen e ndonjë pasurie prej tij. Por duke mbajtur në konsideratë që shuma 10.479 euro është vërtetuar të jetë transferuar në llogarinë e përbashkët të bashkëshortes me shtetasin Ll. Z. në datën 3.9.2003 nga shtetasja M. M. (pra nuk është depozitim në *cash* nga bashkëshortja e subjektit) dhe pjesa më e madhe e saj prej 10.000 euro është tërhequr pas një jave nga ana e znj. C. (në datën 10.9.2003), ashtu sikurse për shumicën, edhe në vlerësimin tim kjo shumë nuk duhet të konsiderohet si pasuri e bashkëshortes së subjektit.

Analiza financiare

14. Për të verifikuar justifikimin e pasurive të deklaruara në deklaratën *Vetting*, të krijuara para fillimit të detyrës dhe gjatë periudhës së rivlerësimit, sikurse është shtjelluar më hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ, në përfundim të hetimit është kryer analiza financiare e subjektit bazuar në vlerën e pasurive, të ardhurat dhe shpenzimet.

14.1. Sa i takon periudhës para fillimit të detyrës është kryer analiza financiare, nga e cila dukej se kishte një balancë negative -3.124.552 lekë, e cila mund të ndryshonte në varësi të parashtrimeve dhe dokumenteve që subjekti do të paraqiste me kalimin e barrës së provës. Kjo balancë ka ardhur kryesisht për shkak se në përfundim të hetimit administrativ është kryer analizë financiare në momentin e kreditimit në rrugë bankare të disa vlerave monetare nga persona të tretë në llogaritë bankare ku bashkëshortja e subjektit është mbajtëse/bashkëmbajtëse e tyre, duke i konsideruar ato si pasuri të bashkëshortëve Cara, në konsideratë të fakteve si vijojnë:

¹⁰ Për shtetasen M. M., subjekti paraqiti: deklaratë noteriale e shtetasës M. M.; mandatpagesa; certifikatë martese M. M.; certifikatë trugun D. S.; dokumentacion sigurimesh greke.

- Kreditimet janë në mënyrë të përsëritur dhe në vlera të konsiderueshme, dhe sikurse ka rezultuar nga hetimi, ka pasur mjaft paqartësi e dyshime në lidhje me burimin e tyre dhe destinacionin e tyre pas tërheqjeve *cash* nga ana e bashkëshortes së subjektit.

- Edhe pse përgjithësisht në periudhën kur janë kryer kreditimet subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë qenë në martese ligjore, nga subjekti është deklaruar bashkëjetesa që në vitin 2004, ndërkohë vërtetohet lidhja e tyre që në vitin 2002 për shkak të blerjes së përbashkët të një apartamenti në ***.

- Në periudhat e kreditimeve deri më 9.12.2009, subjekti ka qenë OPGJ dhe, më pas, në kohën e kryerjes së disa prej kreditimeve, ka qenë prokuror.

Në këto kushte, nga ana e trupit gjykues është vlerësuar se për efekt të procesit të rivlerësimit në kuadër të ligjit nr. 84/2016, një vlerësim tërësor i rrethanave në të cilat janë kryer kreditimet, evidentimi i burimeve të tyre dhe destinacionit të përdorimit, do të ndihmonin Komisionin në krijimin e bindjes për një vendimmarrje sa më objektive.

Në lidhje me bilancin negativ për periudhën përpara detyrës, duke marrë në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, shumica vlerëson se bilanci negativ final është 599.363 lekë.

Sa i takon transaksioneve të kryera nga ana e bashkëshortes së subjektit, shumica vlerëson se: *“Trupi gjykues vlerësoi se subjekti ka pasaktësi, pasi nuk ka deklaruar transaksionet e kryera nga bashkëshortja në llogaritë e përbashkëta apo në emër dhe për llogari të familjarëve të saj apo/dhe transaksionet me pasuritë e paluajtshme të përfaqësuarve prej saj me prokurën e vitit 2000, por u provua se ato nuk janë kryer për fshehje pasurie nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur me të, ndaj dhe nuk duhet të ndikojnë në analizën e përgjithshme financiare të subjektit të rivlerësimit apo, në konkluzionin e përgjithshëm, mbi pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur. Ky qëndrim i mbështetur në parashikimin e nenit 33, pika 5 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është analizuar i parë ngushtë me parashikimin në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon si parakusht për përgjegjësinë disiplinore për efekt të këtij procesi që pasaktësitë, si premisë për shkarkim, të jenë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarimin e pasaktë të të dhënave. Në konkluzion të sa më sipër, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, rrethanat e konstatuara nuk përbëjnë arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe nuk kanë afektuar deklarimin e tij në deklaratën Vetting të vitit 2017”.*

Në vlerësimin tim, duke marrë në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, trajtuar hollësisht më sipër, balanca negative nga vlera prej 3.124.552 lekësh ndryshon në 2.689.931 lekë. Por, unë si anëtare në pakicë vlerësoj se në vetvete kjo balancë nuk është aq penalizuese për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, për shkak se kjo i përket periudhës përpara fillimit të ushtrimit të detyrës si prokuror, krahasimisht me konstatimet në lidhje me dyshimet e ngritura në lidhje me pasuri të luajtshme e të paluajtshme të evidentuara gjatë procesit të rivlerësimit.

Konkretisht, përkundër sa arsyetohet nga shumica, unë, si anëtare në pakicë, në përfundim të procesit, vlerësoj se pas një analize të të gjitha fakteve, provave e rrethanave për të gjitha pasuritë e çdolloji, për të cilat janë ngritur dyshime si: (i) një njësi dhe dyqan në pronësi të shtetasve M. P., Ll. Z. dhe Xh. Z.; si dhe (ii) likuiditete të evidentuara gjatë transaksioneve bankare të kryera prej bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit – u vërtetua se për një pjesë të

konsiderueshme të tyre, të shtjelluara hollësisht në këtë mendim pakice, subjekti nuk ka vërtetuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit dhe që nuk ndodhet në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

14.2. Sa i takon periudhës nga emërimi në detyrë, 10.12.2009 – 31.12.2016, në vlerësimin tim, në analizë të fakteve dhe rrethanave, trajtuar në këtë mendim pakice rast pas rasti, balanca negative prej 2.516.405 lekësh mbetet e pandryshueshme.

Bazuar sa më sipër, në përfundim, unë, si anëtare në pakicë, në gjendjen në të cilat janë provat dhe në raport me faktet dhe rrethanat e rezultuara në përfundim të procesit të rivlerësimit, kam votuar për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Cara, pasi kam arritur në konkluzionin se:

- Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta e që vijnë në kundërshtim me ligjin sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
- Ka mungesë të burimeve financiare për krijimin e pasurive sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit.
- Gjatë hetimit në jo pak raste ka qenë inkoherent dhe kontradiktor në deklarime dhe është përpjekur që të mohojë e anashkalojë fakte e rrethana të rezultuara nga hetimi administrativ.
- Nuk ka vërtetuar bindshëm që nuk është në kushtet e parashikimit të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Për rrjedhojë, gjendet në kushtet e parashikimit të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon kushtet për shkarkimin e subjekteve nga detyra.

Firdes SHULI
Relatore/Kundër